



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 457 Akti

Nr. 507 Vendimi
Tiranë, më 3.2.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektashi	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 28.1.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Elina Kombi**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Elina Kombi, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues në datën 23.12.2019, u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionere Brunilda Bektoshi. Në respektim të legjislacionit në fuqi, mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Ferdinando Buatier de Mongeot. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit. Në datën 17.12.2022, subjekti u njoftua për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ mbi vlerësimin me një kriter, atë të pasurisë dhe rezultatet paraprake të këtij hetimi.

3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, vlerësimi i pasurisë, të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

5. Inspektorati i Lartë i Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurive;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*

¹Shkresë nr. *** prot., datë 12.9.2018.

- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.

7. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumenteve të tjera ligjorë të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

8. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

9. Trupi gjykues, i mbledhur në datën 17.12.2021, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Elina Kombi, njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet paraprake të hetimit administrativ në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10. Znj. Elina Kombi, për një proces të rregullt ligjor, i janë garantuar të drejtat si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërja e trupit gjykues; si dhe përfundimi kryesisht i hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit. Në datën 17.12.2021, subjektit iu dërguan rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

11. Subjekti i rivlerësimit Elina Kombi, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegime dhe prova në datën 25.1.2022 dhe lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, me prapësimet e depozituara në datën 25.1.2022, në materialin shpjegues ka parashtruar disa kërkesa, ku ndër të tjera ka kërkuar rihapjen e hetimit për dy kriteret e tjera, kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional. Trupi gjykues i mbledhur *online* më 26.1.2022, shqyrtoi kërkesat e subjektit, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe pas një vlerësimi paraprak të provave të depozituara nga subjekti, në përfundim, vendosi të refuzojë riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera, duke u shprehur se do të vlerësojë pas seancës dëgjimore, të gjitha provat dhe pretendimet e parashtruara nga subjekti në prapësime, si dhe shpjegimet apo provat gjatë seancës.

Trupi gjykues vlerësoi se provat e administruara deri në seancën dëgjimore, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, ishin të mjaftueshme për përfundimin e procesit administrativ, duke u bazuar vetëm mbi kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

12. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 28.1.2022. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 28.1.2022, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

14. Subjekti i rivlerësimit u paraqit në seancën dëgjimore së bashku me përfaqësuesen ligjore, avokaten E.K, me nr. licence ***, duke deklaruar përfaqësimin e saj në seancë dëgjimore dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit.

15. Në vijim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe, në përfundim, kërkoi riçeljen e hetimit dhe për dy kriteret e tjerë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit Elina Kombi ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, znj. Elina Kombi, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20. Ndërsa sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar

me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësinë për fshehje të pasurisë dhe në deklarimin e rremë apo konfliktin e interesit.

Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga znj. Elina Kombi në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në datën 25.1.2017, në ILDKPKI, ku subjekti ka deklaruar:

1. Apartament banimi² me sip. 69.14 m², në Pogradec, në bashkëpronësi me bashkëshortin, blerë nga Enti Kombëtar i Banesave.

Vlera e deklaruar: 515.281 lekë.

Burimi i krijimit: subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi.

Deklarimi në DPV: në vitin 2003, subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri.

Mënyra e fitimit: me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 27.1.1999.

²Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim nga dokumentet hipotekor me nr. ***, datë 14.11.2001, në të cilin figuron e regjistruar në pronësi të shtetasve Elina Kombi dhe K.Z pasuria apartament me sip. 69.14 m², me nr. ***, ndodhur në z. k. ***; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 27.1.1999, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Enti Kombëtar i Banesave dhe palës blerëse M.Z, B.Z, K.Z dhe Elina Z.

1.1 Hetimi i Komisionit

ZQRPP-ja³ ka konfirmuar se në emër të shtetasve Elina dhe K.Z rezulton pasuria apartament me sip. 69.14 m², regjistruar me nr. pasurie ***.

FSHU-ja⁴ nuk ka konfirmuar asnjë kontratë furnizimi për energji elektrike në emër të subjektit apo personave të lidhur.

1.2 Analiza e fakteve

Nga aktet e dosjes rezulton një kontratë shitblerje nr. ***, datë 27.1.1999, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Entit Kombëtar të Banesave dhe palës blerëse M, B, K dhe Elina Z, të apartamentit me nr. *, kati i tretë, nr. *, me vendndodhje në rrugën “K”, Pogradec, me sip. 69.14 m², kundrejt vlerës 515.281 lekë. Kjo shumë është likuiduar me dy mandatarkëtime, përkatësisht në datat 5.6.1996 dhe 26.1.1999. Sipas kontratës, vlera fillestare e apartamentit ishte në shumën 1.138.627 lekë, por blerësit duke qenë të pastrehë u është zbritur 30% e vlerës totale dhe, si përfundim, kanë paguar shumën 515.281 lekë.

Sipas të dhënave të ardhura nga ZVRPP-ja Pogradec⁵, ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 1.11.2001, subjekti me bashkëshortin kanë blerë nga shtetasit M dhe B. Z (vjehtëri dhe vjehtëra e subjektit) pjesën e tyre takuese në pasurinë apartament me sip. 69.149 m², në shumën 50.000 lekë. Referuar vërtetimit hipotekor, datë 14.11.2001, kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortit.

1.3 Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësitë e blerjes së apartamentit në shumën 515.281 lekë, me të ardhurat e krijuara deri në janar të vitit 1999. Për efekt të analizës, duke qenë se kontrata e shitblerjes së apartamentit me Entin Kombëtar të Banesave, është nënshkruar në datën 27.1.1999, në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat e krijuara nga subjekti dhe familjarët (bashkëshorti, vjehtëri dhe vjehtëra) deri më 31.12.1998. Nga analiza e kryer ka rezultuar një balancë negative në vlerën 151.235 lekë, sipas tabelës vijuese.

Përshkrimi	Periodha 1995 – 1998
Të ardhurat nga pagat dhe pensionet	1.070.726
Shpenzime jetese	706.679
Blerje apartamenti	515.282
Rezultati financiar	- 151.235

Komisioni, për këtë pasuri, konstatoi:

- pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit;
- mosdeklarim të burimit të krijimit të pasurisë.

Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

1.4 Qëndrimi i subjektit

³Shkresë nr. *** prot., datë 4.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Pogradec, drejtuar ILDKPKI-së.

⁴Shkresë nr. *** prot., datë 20.7.2020.

⁵Shkresë nr. *** prot., datë 3.10.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

Subjekti, në prapësimet e depozituara në datën 25.1.2022, ka kundërshtuar përfundimin e Komisionit, duke pretenduar se:

- Në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk i janë marrë në konsideratë të ardhurat nga paga/punësimi i saj për vitin 1994.
- Nuk janë marrë në konsideratë dhe nuk i janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi përpara vitit 1990.
- Nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat nga pensioni i vjehrrit prej vitit 1985 dhe vjehrrës prej vitit 1987.
- Nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat nga aktiviteti privat i vjehrrës e regjistruar si person fizik për vitet 1994 – 1997 (momenti i çregjistrimit). Për këto të ardhura, subjekti ka pretenduar se nuk gjendet dokumentacion, për shkak të trazirave të ndodhura në vitin 1997, duke kërkuar të trajtohet në kushtet e pamundësisë objektive referuar nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016.

1.5 Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit dhe dokumentacionin mbështetës të depozituar pas kalimit të barrës së provës, në vlerësim të akteve ligjore të administruara, ka vendosur të reflektojë në analizë financiare të ardhurat e dokumentuara për periudhën 1990 – 1998, pas përlllogaritjeve rezultati financiar është pozitiv, sipas tabelës vijuese.

Përshkrimi	Periudha 1990 - 1998
Të ardhurat nga pagat dhe pensionet	1 553 875
Shpenzime jetese	1 025 558
Blerje apartamenti	515 282
Rezultati financiar	13 036

Në përfundim, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë apartament në Pogradec dhe ka provuar burimet e ligjshme për krijimin e saj, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës a, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

2. Shtesë anësore⁶ me sip. 104 m² në vazhdim të apartamentit të sipërcituar, në Pogradec

Vlera e deklaruar: 1.400.000 lekë.
 Pjesa në përqindje: në bashkëpronësi me bashkëshortin.
 Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhurat.
 Deklarimi në DPV: në vitin 2009, është deklaruar shtesa anësore.
 Mënyra e fitimit: e legalizuar nga ALUIZNI Korçë, në vitin 2011.

⁶Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: leje legalizimi nr. ***, datë 5.4.2011, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Korçë, për objektin shtesë anësore 5 kate, për banim dhe shërbim në godinën ekzistuese 4 kate, i jepet shtetasve L. K, N.M, A.M dhe K. Z. Sipërfaqja e ndërtimit shtesë 58.6 m², sipërfaqja e parcelës ndërtimore 68.2 m². Numri i kateve mbi tokë 5; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 29.6.2011, të pasurisë me nr. ***, të regjistruar në emër të shtetasit K.Z, apartament me sip. 52 m², me vendndodhje në Lagjen Nr. *, K, Pogradec. Bashkëlidhur harta treguese e regjistrimit.

2.1 Hetimi i Komisionit

ALUIZNI⁷ ka konfirmuar se shtetasi K.Z është pajisur me leje legalizimi me nr. ***, datë 5.4.2011, për “shtesë anësore 5 kate në godinën ekzistuese 4 kate”, Pogradec. Bashkëlidhur përgjigjes janë administruar aktet:

- leje legalizimi nr. ***, datë 5.4.2011, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZI-t Korçë;
- genplan dhe planimetria e pasurisë nr. *** (kati i tretë), në pronësi të shtetasit K.Z, lëshuar në datën 23.9.2010. Sipërfaqja e ndërtimit të shtesës 52 m²;
- genplan dhe planimetria e pasurisë nr. *** (kati i katërt), në pronësi të shtetasit K.Z, lëshuar në datën 23.9.2010. Sipërfaqja e ndërtimit të shtesës 52 m²;
- formulari i pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale, lëshuar në datën 1.3.2011, nga Bashkia Pogradec, për zotëruesit e ndërtimit shtetasit K dhe Elina Z, të objektit 5 kate banim dhe vlera e investimit llogaritur nga ALUIZNI në shumën 2.981.160 lekë (sip. 104 m²);
- fotografitë dhe planimetritë e katit të tretë dhe të katërt të objektit të legalizuar, në zotërim nga shtetasi K.Z;
- referuar formularëve të pagesës të bërë nga z. K Z, rezulton se vetëdeklarimi nga ana e aplikuesve për legalizimin e ndërtesës është bërë me aplikimin nr. A1-***, datë 24.1.2005.

ZQRPP-ja⁸ ka konfirmuar se në emër të shtetasit K.Z rezultojnë pasuritë: nr. ***, truall me sip. 68.2 m² dhe ndërtesë me nr. ***; apartament me sip. 52 m², nr. ***; apartament me sip. 52 m² (shtesa në total 104 m²).

2.2 Analiza e fakteve

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosjen rezulton:

- certifikatë për vërtetim pronësie me nr. ***, datë 29.6.2011, për pasurinë apartament me sip. 52 m² me nr. ***, vol. **, f. ***, z. k. ***, në emër të shtetasit K.Z;
- leja e legalizimit për objektin shtesë anësore 5 kate, me nr. ***, datë 5.4.2011, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Korçë, për banim dhe shërbim në godinën ekzistuese me * kate, në emër të shtetasit K.Z dhe 3 personave të tjerë, ku janë përcaktuar sipërfaqja e ndërtimit shtesë 58.6 m², sipërfaqja e parcelës ndërtimore 68.2 m², sipërfaqe totale për banim 208 m² dhe për aktivitet 58.6 m². Numri i kateve mbi tokë 5.

Referuar akteve të ardhura nga ALUIZNI⁹, tabela e shtesave sipas formularit A1, evidentohet shtesa e vetëdeklaruesit K.Z, në katin e 3 dhe të 4 të banimit, në objektin me * kate, me nr. pasurie ***, sipërfaqe ndërtimi 58.6 m² dhe sipërfaqe e parcelës ndërtimore për kalim pronësie 68.2 m².

Gjithashtu, është nënshkruar kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. ***, datë 29.4.2010, ndërmjet palës shitëse Drejtoria Rajonal e ALUIZNI Korçë dhe blerësve K. Z, etj., për kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore me sipërfaqe 68.2 m², me kusht që blerësi të

⁷Shkresë nr. *** prot., datë 31.8.2020.

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 4.10.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 31.8.2020.

paguajë vlerën e parcelës ndërtimore sipas “*formularit të pagesës së parcelës ndërtimore*”, i cili është pranuar dhe nënshkruar nga palët para lidhjes së kësaj kontrate. Bashkëlidhur kontratës është formulari i pagesës së parcelës ndërtimore, datë 21.12.2009, në të cilën shtetasi K. Z paguan vlerën prej 53.914 lekësh, për shtesë banese 5 kate (kati 3+4), për vlerën e parcelës ndërtimore 104 m².

Nga përmbajtja e akteve të dosjes, rezulton se subjekti ka ndërtuar “shtesë anësore”, përkatësisht në katin e tretë dhe të katërt, në total një sipërfaqe prej 104 m².

Në lidhje me periudhën e kryerjes së punimeve subjekti ka shpjeguar¹⁰ se: “*Punimet janë kryer në harkun kohor prej gati pesë vjetësh, duke filluar në vitin 2005, kjo edhe sipas vetëdeklarimit tek ALUIZNI Korçë, vetëdeklarim nr. A1-*** prot., datë 24.1.2005, me punëtorë të marrë me ditë pune dhe materiale të blera vetë*”.

Në lidhje me koston e ndërtimit të shtesës, subjekti ka shpjeguar¹¹ se: “*Vlera reale e investimit është 1.400.000 lekë dhe përfaqëson shpenzimet faktike të kryera për ndërtimin e sipërfaqes shtesë të legalizuar, gjithsej 104 m², e hipotekuar kati i tretë dhe kati i katërt papafingo sipas ZVRPP-së Pogradec*”.

Vlera e investimit, sipas dokumentacionit të siguruar nga ALUIZNI përfaqëson përlogaritjet e kryera sipas Udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, ‘Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2008’.

Kostoja mesatare e ndërtimit në vitet 2008 dhe 2009 për qytetin e Pogradecit është 27.594 lekë/m².

Referuar materialit fotografik, bashkëngjitur aktit teknik të vlerësimit vërejmë se apartamenti në katin e parë banim është i përfunduar vetëm në karabina dhe muraturë tulle është vlerësuar me të njëjtin çmim si apartamenti në katin e tretë banim që është i përfunduar dhe i vënë në shfrytëzim. Kjo tregon se Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Korçë nuk ka marrë për bazë gjendjen reale të punimeve të kryera në objekt, por e konsideron objektin thjesht si njësi juridike (nr. pasurie).

Përlogaritja¹² që kryen ALUIZNI është e pasaktë dhe e pabazë dhe, për rrjedhojë, llogaritja e vlerës reale të punimeve të kryera në objekt do të llogaritet nëpërmjet situacionit teknik të punimeve të ndërtimit bazuar në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit për vitin përkatës që është ndërtuar objekti (në rastin konkret viti 2006)”.

Për sa i përket koston së shpenzimeve për mobilimin e shtesës me sipërfaqe prej 104 m², që është sa dyfishi i apartamentit që subjekti kishte në zotërim, ajo ka deklaruar¹³ se: “*Mobilimi në apartamentin ekzistues është kryer me mobilet e mëparshme që dispononte vjehrrin dhe vjehrra së bashku me bashkëshortin dhe në vazhdimësi me vlera të vogla. Për pjesën e*

¹⁰Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021.

¹¹Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021.

¹²Subjekti në mbështetje të shpjegimeve të saj, ka depozituar dhe dy dokumente si: aktekspertimi, datë 22.10.2021, për përlogaritjen e koston së ndërtimit për këtë shtesë me sip. 104 m² ku vlera e punimeve, sipas aktit është përcaktuar në shumën 1.448.228 lekë; si provë për të përcaktuar vlerën e investimit për katin e parë në emër të një shtetasi në pallatin ku është bërë shtesa, subjekti ka depozituar një dokument ku sipas llogaritjeve të ALUIZNI Korçë me indeks KO-PG-***, datë 1.4.2010, vlera është 1.434.888, megjithëse ndërtimi është akoma i papërfunduar, i pa suvatur (siç rezulton edhe sot e kësaj dite pasqyruar edhe në fotot e aktit të ekspertimit), pa ndarje në brendësi dhe pa dyer e dritare. Kjo provon që vlera reale e investimit është shumë më e vogël se vlera e llogaritur nga ALUIZNI, i cili përdor metodologji standarde.

¹³Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021.

sipërfaqes së legalizuar përgjatë viteve me mobilje të marra dhe nga apartamenti ekzistues dhe të blera në vlera të vogla që nuk e kalojnë shumën prej 100.000 lekësh”.

Nga verifikimi i deklarimeve në lidhje me ndërtimin e shtesës, duket se nuk përputhet periudha e deklaruar nga subjekti për kryerjen e shtesës, e cila deklaroi se punimet janë kryer në vitet 2005 – 2009, ndërsa referuar formularit të vetëdeklarimit për legalizim, shtesa është deklaruar në janar të vitit 2005. Në të gjitha dokumentet e dosjes, referohet si datë aplikimi 24.1.2005.

Në aktin e kolaudit të vitit 2010, për godinën shtesë 5 kate në banesën kolektive, pjesë e dosjes së depozituar nga ALUIZNI¹⁴, referohet se ndërtimi i shtesës ka nisur në vitin 2002 dhe ka përfunduar në vitin 2004.

2.3 Burimi i krijimit

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar shpenzimet e shtesës në vlerën 1.400.000 lekë, me burim kursimet nga të ardhurat. Nga verifikimi i deklarimeve periodike rezulton se për herë të parë subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2009 *shtesë me sipërfaqe banimi 104 m²*, në shumën 1.400.000 lekë, pa specifikuar burimin e krijimit.

2.4 Analiza financiare

Subjekti ka deklaruar ndërtimin shtesë anësore me sip. 104 m² (52 m² + 52 m²), në shumën 1.400.000 lekë. Referuar akteve të administruara, sipas formularit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale, të lëshuar në datën 1.3.2011, nga Bashkia Pogradec, për zotëruesit e ndërtimit shtetasit K dhe Elina Z, të shtesës në katin 3 dhe 4 banim, vlera e investimit është llogaritur në shumën 2.981.160 lekë.

Komisioni ka marrë si periudhë ndërtimi të “shtesës anësore” vitin 2004, nisur nga fakti që aplikimi për legalizim është depozituar në datën 25.1.2005, duke konsideruar që në momentin e aplikimit, ndërtimi duhet të ketë qenë i përfunduar, pavarësisht se subjekti e kishte deklaruar shtesën për herë të parë në DPV-në e vitit 2009. Në lidhje me koston e ndërtimit të shtesës, duke qenë se jemi përpara faktit të një ndërtimi informal, si dhe në mungesë të dokumentacionit teknik (situacion faktik punimesh) për ndërtimin e shtesës, Komisioni arsyetoi se për një qëndrim sa më afër realitetit, si dhe referuar standardit të mbajtur në raste analoge, kostoja e ndërtimit të llogaritet duke marrë si referencë çmimet e EKB-së për vitin 2004 dhe sipas përlllogaritjeve investimi për ndërtimin e shtesës me sip. 104 m² ka rezultuar në shumën 2.607.176 lekë.

Analiza financiare për të vlerësuar mundësitë për ndërtimin e shtesës anësore

Përshkrimi	2004
Pasuri	6 505 940
Shtesë në apartamentin ekzistues me sip. 104 m ²	2 607 176
Diferencë likuiditeti	3 898 764
Detyrime	-
Pasuri neto	6 505 940
Të ardhura	1 454 741
Të ardhura nga paga të subjektit	990 190

¹⁴Ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 31.8.2020.

Të ardhura nga paga të bashkëshortit	195 294
Të ardhura nga pensioni M. Z	150 144
Të ardhura nga pensioni B. Z	101 538
Të ardhura nga interesat e depozitave	17 575
Shpenzime	547 120
Shpenzime jetese	469 320
Shpenzime shkollimi	77 800
Rezultati financiar	- 5 598 319

Sipas analizës financiare të kryer për vitin 2004, subjekti rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 5.598.319 lekë, pasi nuk justifikon me burime të ligjshme ndërtimin e shtesës, rritjen e likuiditeteve në bankë¹⁵, si dhe përballimin e shpenzimeve të tjera familjare.

2.5 Komisioni, për këtë pasuri, konstatoi:

- mospërputhje deklarimesh lidhur me periudhën e ndërtimit të shtesës anësore;
- mungesë deklarimi lidhur me burimin e krijimit;
- mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, investimet në bankë dhe përballimin e shpenzimeve. Balancë negative në shumën 5.598.319 lekë, për vitin 2004.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

2.6 Qëndrimi i subjektit

Në prapësime të rezultateve të hetimit, depozituar në datën 25.1.2022, subjekti ka paraqitur disa pretendime, si dhe dokumentacion mbështetës si vijon:

Në lidhje me analizën financiare, Komisioni duhet të mbajë në konsideratë faktet vijuese, për të cilat subjekti kërkon të bëhen ndryshime në analizën financiare, si:

i. Periudha e ndërtimit të shtesës

- Subjekti ka kundërshtuar faktin që Komisioni ka vlerësuar se shtesa kishte përfunduar së ndërtuari në vitin 2004, duke argumentuar se në këtë vit nuk ishte nisur ende ndërtimi. Subjekti ka argumentuar se plotësimi i formularit të vetëdeklarimit për legalizimin e ndërtimeve informale dhe depozitimi pranë ALUIZNI-t në datën 24.1.2005 është koha e fillimit të punimeve. Subjekti, në prapësimet me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore, deklaron se në vitin 2005 ishin hedhur vetëm themelet, ndërsa koha e ndërtimit nga subjekti të pjesës takuese të shtesës shtrihet në vitet 2006, 2008 dhe 2009.

- Subjekti për të mbështetur pretendimet ka depozituar *ortofoto* të marra nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), të vitit 2007, të godinës së pallatit të saj,

¹⁵Në aneksin nr. 1 të raportit shpjegohet analiza e krijimit të likuiditeteve në bankë në vitin 2004.

me të cilin pretendon të provojë se nuk evidentohet ndërtim/shtesë në godinën ekzistuese, ndërkohë që në vitin 2015, nga fotografimet (*ortofoto*) rezulton ndërtimi i shtesës i përfunduar.

- Subjekti në mbështetje të këtyre shpjegimeve, sjell në vëmendje faktin se shtesa është deklaruar për herë të parë në DPV-në e vitit 2009, pasi në atë vit kishte përfunduar ndërtimi i shtesës dhe shtesa anësore ishte në proces legalizimi.

- Subjekti ka shpjeguar se mungesa e deklarimit të “shtesës anësore” në DPV-të për vitet 2007 dhe 2008 ka ndodhur edhe për arsye se nuk kanë disponuar dokumentacion mbështetës. Deklarimi i kësaj sipërfaqe në deklaratat e mëvonshme periodike dhe në deklaratën *Vetting*, si pjesë e shtuar e apartamentit ekzistues, është kryer kur objekti shtesë u përfundua. Ky fakt nuk sjellë pamjaftueshmëri deklarimi të shoqëruar me mungesë të burimit financiar të ligjshëm në kuptim pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Nisur nga fakti që ndërtimi informal ka marrë formë ligjore në vitin 2009, deklarimi është bërë në këtë kohë. Gjithashtu, në vijim të këtij argumenti, subjekti shpjegoi se detyrimi për deklarim të shpenzimeve të kryera, ka hyrë në fuqi në vitin 2012 dhe as në vitin 2008, nuk ka pasur detyrim për deklarim të këtyre shpenzimeve.

Në lidhje me këtë fakt, subjekti ka shpjeguar se është pyetur edhe nga ILDKPKI-ja, ku ka dhënë shpjegime sipas procesverbalit të datës 31.03.2016. Pas verifikimeve nuk rezultoi asnjë problematikë në lidhje me deklaratat e saj ndër vite.

ii. Kostoja e ndërtimit të shtesës

- Subjekti ka pretenduar se sipërfaqja e shtesës prej 104 m² është interpretuar dhe konceptuar nga Komisioni si një ndërtim i ri, në një kohë që ndërtimi i kryer është “shtesë e sipërfaqes së banimit në vazhdim të apartamentit ekzistues”, e cila duket qartazi nga fotot bashkëlidhur, që është ngritur mbi dy mure ekzistuese. Gjithashtu, për ndërtimin e saj nuk ka pasur kosto shtesë, si për të bërë projektin, studime gjeologjike shpenzime plotësuese, etj. Gjithashtu, kjo shtesë është ndërtuar me krahë pune të lirë, vit pas viti.

- Subjekti ka kërkuar që kostoja e ndërtimit të shtesës me sip. 104 m² duhet të llogaritet nga Komisioni, në shumën sa është deklaruar prej saj 1.400.000 lekë dhe jo bazuar në çmimin e EKB-së, pasi vetë Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Korçë ka pranuar se ndërtimi është bërë në vitin 2008 (pra, jo në vitin 2004), ndërsa llogaritja e investimit është bërë sipas Udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2008”. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka depozituar aktekspertim të një eksperti vlerësues privat, ku vlera e investimit të kryer ka rezultuar 1.448.228 lekë.

- Subjekti ka pretenduar se përlllogaritja e kryer nga ALUIZNI, për koston e ndërtimit bazuar mbi çmimet e EKB-së, është e gabuar pasi po t’i referohemi përlllogaritjes që i janë bërë fqinjës në katin e parë të ndërtimit, duke llogaritur si kosto investimi të shtesës së tij me sip. 52 m², shumën 1.400.000 lekë, ndërkohë që kur është bërë llogaritja e koston së investimit për këtë ndërtim nuk kishte përfunduar plotësisht ndërtimi i saj nga fqinja dhe ALUIZNI e ka llogaritur si të përfunduar.

- Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se nga llogaritja e çmimit të EKB-së, Komisioni duhet të zbrësë shumën prej 20% të vlerës që përfaqëson TVSH-në + 5% fondin rezervë. Kjo metodologji llogaritjeje nuk është mbajtur parasysh nga Komisioni.

iii. Të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i subjektit në SHBA dhe prindërit e saj në Greqi

Subjekti ka pretenduar që Komisioni duhet të marrë në konsideratë të ardhurat e deklaruara prej saj, si të përfituara në SHBA nga ajo dhe bashkëshorti, të deklaruar në mënyrë të rregullt në deklaratimet periodike vjetore, si dhe shumën 20.000 USD, si e dhënë nga prindërit, të ardhura këto të ligjshme (të trajtuara në vijim në pikën 10 dhe 11, të këtij vendimi).

iv. Shpenzime udhëtimi

Subjekti ka kundërshtuar shpenzimet e llogaritura nga Komisioni në analizën financiare për udhëtimet e saj jashtë shtetit, duke argumentuar se për udhëtimet e saj në Greqi ka qëndruar te prindërit dhe motrat dhe për udhëtimet në Qipro ka qëndruar te vëllai. Për këto arsye, analiza financiare e Komisionit duhet të ribëhet duke mbajtur në konsideratë faktet konkrete.

v. Subjekti ka pretenduar se pas analizimit të interesave bankare të përlllogaritura nga Komisioni, ka rezultuar që ato të mos jenë përlllogaritur saktë, pasi referuar informacionit bankar rezultoi që interesat e marra të jenë më shumë nga sa ka llogaritur Komisioni. Për këtë arsye, për vitet në fjalë ka kërkuar rillogaritje të interesave të depozitave bankare ndër vite.

2.7 Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues i Komisionit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet¹⁶ dhe provat e parashtruara prej saj, çmon se:

i. Lidhur me periudhën e ndërtimit të shtesës

Komisioni bazuar në dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti pas prapësimeve, nga pamja e mundësuar nga *ortofoto*-ja e vitit 2007 e godinës së pallatit, marrë nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), duket se nuk ka gjurmë të ndonjë ndërtimit mbi tokë, pra, nuk evidentohet shtesë anësore në godinën ekzistuese, ndërkohë që pamja nga *ortofoto* e vitit 2015, duket qartë shtesa anësore e përfunduar, në formë “L”, e mbuluar me çati, ngjitur me pallatin ku subjekti kishte banesën në qytetin e Pogradecit.

Nisur nga ky fakt, shtesa anësore nuk mund të kishte përfunduar në vitin 2004, pasi pamja nga *ortofoto*-ja e vitit 2007 nuk rezultoi të ketë gjurmë të shtesës anësore, të ngritur mbi tokë (mund të jenë hedhur vetëm themelet, pasi fotografimi nga lart nuk i evidenton).

- E pyetur nga Komisioni, lidhur me periudhën e ndërtimit të shtesës, subjekti në përgjigje të pyetësorit ka deklaruar se: *“Punimet janë kryer në harkun kohor prej gati pesë vjetësh duke filluar në vitin 2005, kjo edhe sipas formularit të vetëdeklarimit tek ALUIZNI Korçë, me nr. A1-*** prot., datë 24.1.2005, ndërtuar me punëtorë të marrë me ditë pune dhe materiale të blera vetë”, duke deklaruar se shtesa me sip. 104 m² ka kushtuar në shumën 1.400.000 lekë”*. Subjekti, si në prapësime ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore, pretendoi se në momentin e deklaratimit pranë ALUIZNI-t në vitin 2005 kanë qenë ndërtuar vetëm themelet dhe ndërtimi i shtesës ka filluar në vitin 2006, në vitin 2007 nuk u ndërtua, pasi subjekti dhe bashkëshorti për arsye objektive kanë shkuar në SHBA dhe ndërtimi i shtesës ka vijuar në vitin 2008 dhe

¹⁶Depozituar me prapësimet e datës 25.1.2022.

përfunduar në vitin 2009. Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore, subjekti në DPV-në e vitit 2009 ka deklaruar për herë të parë shtesë banimi me sip. 104 m².

Trupi gjykues, duke rivlerësuar rrethanat e çështjes dhe provat e depozituara nga subjekti, si dhe mbështetur edhe në deklarin periodik vjetor të subjektit të vitit 2009, ku shtesa anësore është deklaruar për herë të parë, përfundimisht i konsideron bindëse pretendimet e subjektit se ndërtimi i shtesës nuk mund të jetë kryer në vitin 2004. Gjithashtu, lidhur me kohëzgjatjen e ndërtimit, ndërtimi i shtesës duhet të ketë filluar në vitin 2006 dhe pjesa më e madhe e ndërtimit gati 70% mund të jetë ndërtuar në vitin 2008 dhe se shtesa ka përfunduar së ndërtuari në vitin 2009. Shpjegimet e subjektit përputhen me deklarin e bëra prej saj në DPV-në e vitit 2009, në përputhje kjo dhe me dispozitën e parashikuar në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit deklarinet e interesave private pasurore, të paraqitura më parë në ILDKPKI, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.

Përfundimisht, Komisioni ndodhur në një situatë, ku dokumentacioni është i paplote për të vlerësuar saktë çështjen, si dhe nisur nga nevoja për të vlerësuar çështjen sa më afër realitetit, i gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 51¹⁷ të ligjit nr. 84/2016, ka analizuar mundësinë për investim e subjektit të shtrirë në vite, konkretisht të shtrira në vitet 2006, 2008 dhe 2009, siç shihet në tabelën vijuese.

ii. Lidhur me koston e ndërtimit të shtesës anësore

Trupi gjykues, në lidhje me koston e ndërtimit të shtesës nga subjekti dhe në mungesë të dokumentacionit provues mbi një preventiv faktik shpenzimesh, ka vlerësuar t'i qëndrojë standardit të përdorur edhe në raste të ngjashme, analoge duke përllogaritur "koston e ndërtimit të shtesës" bazuar në çmimet e EKB-së për vitin 2008, respektivisht në vlerën 27.594 lekë/m².

Referuar këtij çmimi, vlera e shtesës u përllogarit në shumën 2.869.776 lekë. Mbështetur në shpjegimet e subjektit, ku referon se ndërtimi ka filluar në vitin 2005, trupi gjykues, në vlerësimin përfundimtar, ka vendosur të shpërndajë këtë vlerë investimi në vite si vijon:

- Në vitin 2005, shumën 573.955 lekë ose 1/5 e të gjithë vlerës së investimit të shtesës, për investimin në themele¹⁸ të shtesës. Pjesa e mbetur prej 4/5 është ndarë si vijon:
- Në vitin 2006, shumën 1.607.075 lekë ose 70% të shumës së mbetur të investimit: $(2.869.776 - 573.955) \times 70\%$.
- Në vitin 2009 shumën 688.746 lekë ose 30% të shumës së mbetur të investimit: $(2.869.776 - 573.955) \times 30\%$.

¹⁷Neni 51 i ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, kur subjekti nuk paraqet prova, apo provat që disponohen janë të paplota, Komisioni dhe Kolegji mund të vendosin bazuar në provat që disponojnë në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e tyre të brendshme.

¹⁸Në kushtet e mungesës se një preventivi për themelet, nisur nga praktika inxhinierike ekspertet përdorin si referencë 1/5 e vlerës së objektit për ndërtime deri në 5 kate.

iii. Të ardhurat e bashkëshortit në SHBA dhe prindërve në Greqi

Komisioni ka përfshirë në analizën financiare vetëm të ardhurat për të cilat janë paguar tatimet, si të ardhura të ligjshme në zbatim të pikës 3, të nenit D, Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas arsytimit në vijim të këtij vendimi në pikën 10 dhe 11.

iv. Shpenzime udhëtimi

Komisioni, analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, mbështetur edhe në aktet provuese të administruara në prapësime, rishikoi shpenzimet e udhëtimeve/TIMS, duke reflektuar në analizën financiare ndryshimet përkatëse. Gjithashtu, referuar akteve të administruara pas prapësimeve, analiza për ndërtimin e shtesës u përllorarit bazuar në çmimet sipas EKB-së për vitin 2008 dhe, për rrjedhojë, rezultati financiar pas prapësimeve për këtë pasuri ka pësuar ndryshime, sipas tabelës vijuese.

Tabela e përditësuar pas prapësimeve

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009
Pasuri	556 308	1 375 688	2 537 889	1 232 601
Automjet tip “Mercedes-Benz”	250 000			
Shtesë me sip. 104 m ²	573 955			688 746
Automjet				375 920
Diferencë likuiditeti	-267 647	1 375 688	930 814	167 935
Likuiditete në fund të vitit	4 025 091	5 400 780	6 331 594	6 499 529
Gjendje <i>cash</i>			700 000	700 000
Likuiditete në bankë	4 025 091	5 400 780	5 631 594	5 799 529
Detyrime	-	-	-	-
Pasuri neto	556 308	1 375 688	2 537 889	1 232 601
Të ardhura	2 315 753	2 758 057	2 724 526	2 769 937
Të ardhura nga paga subjekti	957 343	918 087	1 032 964	1 161 617
Të ardhura nga paga bashkëshorti	721 684	1 389 617	896 392	1 117 301
Të ardhura nga pensioni i M. Z.	174 978	186 696	200 356	258 924
Të ardhura nga pensioni i B. Z.	119 640	125 322	134 346	147 628
Të ardhura nga shitja e automjetit 2006	250 000			
Të ardhura nga shitja e automjetit 2008			300 000	
Të ardhura nga interesat e depozitave	92 108	138 335	160 468	84 467
Shpenzime	938 324	958 156	1 094 112	1 334 122
Shpenzime jetese	547 785	421 245	819 720	819 720
Shpenzime udhëtimi	308 639	437 694	174 792	414 802
Shpenzime shkollimi	81 900	90 000	99 600	99 600
Shpenzime për lindjen e vajzës		9 216		
Rezultati financiar	821 121	424 213	- 907 475	203 214

Në përfundim, nga analiza e kryer, rezulton se subjekti ka pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për të kryer investimin në “shtesë anësore”, në vitin 2008, në shumën 907.475 lekë.

v. Në lidhje me interesat bankare, pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, Komisioni verifikoi edhe një herë llogaritjet e kryera, të cilat rezultuan se ishin kryer saktë nga Komisioni dhe nuk pësuan ndryshime pas prapësimeve të subjektit.

Përfundimisht, për ndërtimin e shtesës anësore me sip. 104 m², referuar faktit që subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme për të kryer këtë investim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3, të neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar investimet e kryera.

3. Llogari¹⁹ në shumën 0.79 lekë, në “Credins Bank”

4. Llogari²⁰ në shumën 8.100 euro, në “Credins Bank”, kursime nga të ardhurat e familjes.

“Credins Bank”²¹ ka konfirmuar në emër të shtetases Elina Kombi llogari page me gjendje në vlerën 0.79 lekë dhe depozitë me gjendje në vlerën 8.100 euro.

Nga verifikimi i Komisionit ka rezultuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga “Credins Bank”.

PASURI TË REGJISTRUARA VEÇMAS NGA BASHKËSHORTI I SUBJEKTIT

5. Pasuri e llojit “arë”²², me sip. 13.280 m², truall me sip. 220 m² dhe ndërtesë me sip. 124 m². Pjesa takuese: 100% në pronësi të bashkëshortit të subjektit.

Burimi i krijimit: përfituar me çeljen e dëshmisë së trashëgimisë testamentare nga babai.
Deklarimi në DPV: e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se ka përfituar pasuri nga babai i tij pas çeljes së dëshmisë testamentare.

¹⁹Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës konfirmim nr. *** prot., datë 20.1.2017, lëshuar nga “Credins Bank” për znj. Elina Kombi, e cila është kliente e bankës dhe disponon llogari në vlerën 0.79 lekë.

²⁰Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës konfirmim nr. *** prot., datë 20.1.2017, lëshuar nga “Credins Bank” për znj. Elina Kombi, e cila disponon llogari në vlerën 8.100 euro.

²¹Me shkresën nr. *** prot., datë 10.8.2017.

²²Bashkëlidhur deklaratës: certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 10.2.2015, të pasurisë “arë” me sipërfaqe totale 13.280 m², regjistruar me nr. ***, në emër të shtetasit K.Z, me vendndodhje në G, Pogradec. Bashkëlidhur ndodhet harta treguese dhe kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilën evidentohet kalimi i pronësisë në emër të shtetasit K.Z, në datën 22.1.2015 me dëshmi trashëgimie. Data e regjistrimit fillestar të pasurisë më 22.11.2011, në emër të shtetasit M.Z, përfituar me ndarje pasurie. Në datën 14.12.2011 është bërë rivlerësimi i pasurisë në vlerën 3.670.592 lekë; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 10.2.2015, të pasurisë “truall” me sipërfaqe totale 220 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 124 m², regjistruar me nr. ***, në emër të shtetasit K.Z, me vendndodhje në G, Pogradec. Bashkëlidhur ndodhet harta treguese dhe kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilën evidentohet kalimi i pronësisë në emër të shtetasit K.Z në datën 22.1.2015 me dëshmi trashëgimie. Data e regjistrimit fillestar të pasurisë më 22.11.2011, në emër të shtetasit M.Z, përfituar me ndarje pasurie. Sipas kartelës, në rubrikën e përshkrimeve, është shënuar se mbi këtë pasuri, në datën 26.10.2010, është përfituar leje ndërtimi nr. **, për objektin “magazinë dhe rezidencë banimi 3 kate”; faturë tatimore shitje nr. ***, datë 22.9.2011, me palë shitëse shoqërinë “V” sh.p.k. dhe palë blerëse M. Z. Sipas faturës, objekti i shitjes është situacion përfundimtar i objektit “magazinë dhe rezidencë banimi 3 kate” në shumën totale 1.211.912 lekë; vendim nr. ***, datë 9.6.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për lëshim dëshmi trashëgimie për trashëgimlënësin N.Z, duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë shtetasit Z.Z, M.Z, N.Z, Sh.Z, H.Z, në pjesë të barabarta nga 1/5 secili mbi pasuritë dhe detyrimet e trashëgimlënësit; njoftim vendimi nr. *** prot., datë 6.3.2006, lëshuar nga Komisioni Vendor i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Korçë, në të cilin është bashkëlidhur vendimi nr. **, datë 1.3.2006, për njohjen e të drejtës së pronësisë, kthimit dhe kompensimit të pronave të subjektit të shpronësuar N.Z si vijon: 6.5 ha korije në vendin e quajtur “Z”, 1.35 ha korije në vendin e quajtur “L i C”, 9.1 ha korije në vendin e quajtur “P”, 4.34 ha korije në vendin e quajtur “G e H” dhe 3.996 m² tokë arë në vendin e quajtur “V i M”, të gjitha të ndodhura në fshatin Z(G), Pogradec. Referuar vendimit të KVKKP-së, trashëgimtarit M.Z përfiton 1/5 pjesë takuese të pasurive të mësipërme; planvendosjet e pronave të mësipërme, lëshuar nga Komisioni Vendor i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Korçë; testament nr. ** i akteve të vullnetit të fundit, datë 9.6.2008, lëshuar nga testatori M.Z, i cili deklaron se dëshiron të disponojë gjithë pasurinë e tij djalit të tij K. Z dhe përjashton nga trashëgimia të gjithë trashëgimtarët e tjerë; procesverbal nr. ***, datë 22.1.2015, për çelje testamenti, në të cilin shtetasi K.Z kërkon çeljen e testamentit nr. ** të akteve të vullnetit të fundit datë 9.6.2008; dëshmi trashëgimie testamentare dhe ligjore nr. ***, datë 22.1.2015, me kërkesë të shtetasit K.Z është vendosur lëshimi i dëshmisë testamentare të trashëgimlënësit M.Z dhe njohjen si trashëgimtar testamentar të tij K.Z, i cili trashëgon të gjithë pasurinë trashëgimore dhe detyrimet e lidhura me të.

Mënyra e fitimit: kaluar në pronësi të shtetasit K.Z pas çeljes së dëshmisë testamentare me nr. **, datë 22.1.2015, të shtetasit M.Z, regjistruar në ZVRPP-në Pogradec, më 10.2.2015.

5.1 Hetimi i Komisionit

ASHK-ja²³ nuk ka dhënë informacion për pasuritë e subjektit dhe të bashkëshortit dhe nga verifikimi i sistemit *online* nuk rezultojnë të dhëna në sistemin dixhital të këtij institucioni.

ZQRPP-ja²⁴ ka konfirmuar se në emër të shtetasit K.Z rezulton pasuria arë me sip. 13.280 m², nr. ***, si dhe pasuria truall me sip. 220 m², nr. **. Bashkëlidhur shkresës ndodhen certifikatat e pronësisë, kartelat, hartat treguese të pasurive të mësipërme, si dhe dëshmia e trashëgimisë testamentare dhe ligjore me nr. **, datë 22.1.2015.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë²⁵ ka konfirmuar se pranë këtij institucioni nuk ka pasur procedime penale të regjistruara apo të hetuara nga subjekti i rivlerësimit me palë kallëzues/të kallëzuar shoqërinë “V” sh.p.k. dhe administratorin e kësaj shoqërie z. G.A, të cilët kanë qenë të angazhuar për ndërtimin e godinës 3 kate.

5.2 Analiza e fakteve

Nga aktet e dosjes rezulton se bashkëshorti i subjektit ka regjistruar pasurinë e llojit “arë” me sip. 13.280 m², nr. pasurie ***, sipas certifikatës për vërtetim pronësie datë 10.2.2015, me vendndodhje në G, Pogradec.

Bashkëshorti i subjektit ka regjistruar pasurinë truall me sipërfaqe totale 220 m² dhe ndërtesën me sip. 124 m², sipas certifikatës për vërtetim pronësie të datës 10.2.2015, me vendndodhje në G, Pogradec. Bashkëlidhur ndodhet harta treguese dhe kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilën evidentohet kalimi i pronësisë në emër të shtetasit K.Z më 22.1.2015. Sipas kartelës, në rubrikën e përshkrimeve, është shënuar se mbi këtë pasuri, në datën 26.10.2010, është marre leje ndërtimi nr. ** për objektin “magazinë dhe rezidencë banimi 3 kate”.

Pasuritë arë, truall dhe ndërtesë i kanë kaluar bashkëshortit të subjektit me dëshmi trashëgimie nga babai i tij. Data e regjistrimit fillestar të pasurisë më 22.11.2011, në emër të shtetasit M. Z, përfituar trualli nëpërmjet pjesëtimit të pasurisë. Në dosje rezulton edhe një faturë tatimore shitjeje nr. **, datë 22.9.2011, me palë shitëse shoqërinë “V” sh.p.k. dhe palë blerëse M.Z. Referuar faturës, objekti i lëshimit të faturës është situacion përfundimtar i objektit “magazinë dhe rezidencë banimi 3 kate” në shumën totale 1.211.912 lekë.

Referuar akteve ka rezultuar se kjo pasuri (arë) është përfituar nga vjehri i subjektit me trashëgimi nga babai i tij, si një nga 5 trashëgimtarët ligjorë të pasurisë, të cilët e kanë pjesëtuar pasurinë e trashëguar në mënyrë vullnetare.

Referuar akteve rezulton se vjehri i subjektit, z. M.Z, pasurinë në pronësi të tij, e ka disponuar me testamentin me nr. **, datë 9.6.2008, ku ka shfaqur vullnetin për t’ia kaluar këtë pasuri djalit të tij, z. K. Z.

²³Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2020.

²⁴Shkresës nr. *** prot., datë 4.10.2017, i ka bashkëlidhur përgjigjen nr. *** prot., datë 22.9.2017, të ZVRPP-së Pogradec, drejtuar ILDKPKI-së.

²⁵Shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2021.

Në vijim është lëshuar dëshmia e trashëgimisë testamentare nr. ***, datë 22.1.2015. Me kërkesë të shtetasit K.Z është vendosur lëshimi i dëshmisë testamentare të trashëgimlënësit M. Z dhe njohja si trashëgimtar testamentar të z. K.Z.

ZVRPP-ja Pogradec²⁶ ka depozituar dokumentacion ligjor të pasurisë nr. *** në emër të shtetasit M. Z:

- certifikatë për vërtetim pronësie datë 10.5.2006, të pasurisë së llojit “arë” në G, Pogradec, regjistruar me nr. ***, sip. 13.500 m², në bashkëpronësi të familjarëve Z në të cilën shtetasit M.Z i takon 4/20 pjesë, shoqëruar me kartelën e pasurisë;
- kartelën e pasurisë “arë” në G, Pogradec, regjistruar me nr. ***, sip. 43.400 m², në bashkëpronësi të familjarëve Z, në të cilën shtetasit M. Z i takon 4/20 pjesë;
- aktmarrëveshje pjesëtimi vullnetar nr. ***, datë 28.6.2006, në të cilën bashkëpronarët e pasurive nr. ***, ***, *** dhe *** kanë rënë dakord për ndarjen e tyre. Sipas kësaj marrëveshjeje shtetasi M.Z përfiton në pasurinë: nr. *** sipërfaqen 16.080 m²; nr. *** sipërfaqen 13.000 m²; nr. *** të përbërë prej 13.500 m², do të mbetet e gjitha në pronësi të tij, ndërsa në pasurinë nr. *** nuk do të përfitojë pjesë takuese.

5.3 Ndërtimi i godinës 3 kate

Nga aktet e dosjes, sikurse u shpjegua më sipër, në pasurinë “arë” me nr. ***, të përfituar me testament nga bashkëshorti i subjektit, ndodhet pasuria truall me nr. *** dhe sip. 124 m² ndërtesë. Ka rezultuar se vjehri i subjektit, i ndjeri M. Z, ka bërë një ndërtim 3 kate me leje²⁷ në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5.4 Burimi i krijimit për ndërtimin 3 kate

Duke marrë në konsideratë faktin se pasuritë truall dhe ndërtesë janë pasuri në pronësi të bashkëshortit të subjektit, si dhe këta të fundit kanë kontribuar për ndërtimin e saj, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimin të provojë burimet e ligjshme të të ardhurave të vjehrit që kanë shërbyer për ndërtimin e magazinës dhe rezidencës së banimit 3 kate.

Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar se i ka dhënë vjehrit M.Z shumën 1.436.000 lekë për të kryer investime në pronën e tij. Në vijim, nga verifikimi i DPV-ve, nuk rezulton që kjo shumë t’i jetë kthyer sërish subjektit nga vjehri.

Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar shumën 62.900 USD, tërhequr nga depozita në dollarë në “Intesa Sanpaolo Bank”. Referuar statementit bankar të llogarisë së subjektit, nga

²⁶Me e-mail-in e datës 7.9.2018, drejtuar ILDKPKI-së.

²⁷Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ZVRPP-ja Pogradec me e-mail-in e datës 7.9.2018, drejtuar ILDKPKI-së; dokumentacioni ligjor i përfitimit të lejes së ndërtimit të ndërtesës në emër të shtetasit M. Z: kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 29.10.2010, nënshkruar ndërmjet porositësit M.Z dhe sipërmarrësit shoqërisë “V” sh.p.k. Referuar kontratës, porositësi deklaroi se është pronar mbi një sipërfaqe trualli prej 250 m², ndodhur në fshatin G, Pogradec dhe kërkon të pajiset me leje për ndërtimin mbi këtë sipërfaqe toke të një objekti “rezidencë dy kate + çati e shfrytëzuar + rrethimin e objektit” me sip. 250 m². Koha e ndërtimit brenda një periudhe 2-vjeçare duke filluar nga data e tërheqjes së lejes së ndërtimit. Materialet për ndërtimin do të sigurohen nga porositësi. Shpenzimet për ndërtimin e objektit do të jenë sipas vlerës së preventivit që do të hartohet në përputhje me projektin e ndërtimit të objektit dhe të cilat do të paguheshin nga porositësi; vendim nr. **, datë 29.10.2010, i KRRT-së, për miratimin e destinacionit të ndërtimit të objektit “magazinë dhe rezidencë banimi 3 kate”, në emër të shtetasit M. Z; akt piketimi në objekt datë 14.2.2011, akt kontrolli mbi përfundimin e themeleve datë 26.2.2011, akt kontrolli mbi përfundimin e karabinasë datë 15.5.2011 dhe akt kontrolli mbi përfundimin e sistemimit të objektit nga Sektori i Urbanistikës, Komuna B; akt kolaudimi tekniko-ekonomik i objektit “magazinë dhe rezidencë banimi 3 kate” me investitor M.Z. Vlera e objektit sipas preventivit të kontraktorit të përcaktuar në kontratë është 1.211.912 lekë. Punimet për ndërtimin e objektit kanë filluar më 14.2.2011 dhe kanë përfunduar më 18.10.2011; kërkesë për miratimin e lejes së shfrytëzimit të objektit “magazinë dhe rezidencë banimi 3 kate”; leje e shfrytëzimit të objektit “magazinë dhe rezidencë banimi me 3 kate”, datë 11.11.2011; shkresë nr. *** prot., datë 14.11.2011, nga Komuna B, drejtuar ZVRPP-së Pogradec, dërgim dokumentacioni për regjistrim pasurie.

përshkrimi i veprimit bankar rezulton që shuma të jetë tërhequr për të investuar në një pasuri të vjehrrit.

Subjekti ka shpjeguar²⁸ se punimet për ndërtimin e godinës kanë filluar në vitin 2010 dhe kanë vazhduar për rreth 3-4 vjet.

Në lidhje me koston totale të investimit të kryer, subjekti ka shpjeguar²⁹ se nuk është në dijeni të vlerës totale të investimit të kryer në këtë pasuri, pasi kjo ka qenë në pronësi të vjehrrit, të ndjerit M.Z, i cili e ka zotëruar deri në vitin 2014 kur ka ndërruar jetë.

Shumat e tërhequra nga llogaria bankare prej 62.900 USD dhe 1.436.000 lekësh i janë dhënë vjehrrit për investim në ndërtim (shtëpi fshati prej guri dhe druri). Subjekti ka argumentuar se këto shuma i janë dhënë vjehrrit jo në formën e huas, por për t'i përdorur për investimet e kryera në pronat e sipërcituara.

Gjithashtu, punime për mbjellje drurësh frutorë të ndryshëm në sipërfaqen tokë arë 13.500 m² dhe 6.500 m² pyll, të kryera nga vjehrrit në pronat e tij, të trashëguara dhe të fituara me vendimin nr. **, datë 1.3.2006, të Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave Qarku Korçë.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitohet situacionet dhe pagesën e faturave për shoqërinë "V" sh.p.k. Subjekti ka shpjeguar se të gjitha këto pagesa janë kryer prej vjehrrit M.Z, për të cilat nuk janë në dijeni dhe as nuk i disponojnë.

Në përgjigjet e pyetësorit³⁰ subjekti ka shpjeguar, ndër të tjera, se: "... burimet e ligjshme të vjehrrit për investimin e kryer në 'G.H.Z' janë: (i) të ardhurat e akumuluar ndër vite prej tij, bashkëshortes së tij (pensionet) dhe gjithë familjes; (ii) shuma e akumuluar në depozitën në Bankën Amerikane të Shqipërisë; (iii) shuma prej 1.436.000 lekësh kursime familjare; (iv) të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit të deklaruara në DPV-në e viteve 2010 dhe 2011".

Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve vërtetimin nr. *** prot., datë 15.10.2021, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Korçë dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 15.10.2021, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Korçë për të provuar të ardhurat nga pensionet e prindërve të bashkëshortit.

Komisioni, në vlerësim të çështjes, ka marrë në konsideratë faktet vijuese:

- Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2010 shumën 1.436.000 lekë, dhënë z. M.Z për të kryer investime në pronën e trashëguar nga i ati.
- Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2011 shumën 62.900 USD, tërhequr nga depozita në bankë dhe i është dhënë z. M. Z për të kryer investime në pronën e tij të trashëguar nga i ati.
- Nga verifikimi i statementit në bankë u evidentua tërheqja e shumës 62.900 USD në datën 1.9.2011.

²⁸Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021.

²⁹Nr. 2, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021.

³⁰Ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 17.11.2021.

- BKT-ja, me shkresën e datës 27.7.2020, ka konfirmuar një pagesë në shumën 1.211.912 lekë për llogari të shoqërisë “V.” sh.p.k., nga shtetasi K. Z, me përshkrimin “K.Z derdh në llogari të shoqërisë, likuidim fature nr. *** për punime F/O M.Z”, në datën 30.11.2011.
- Shtetasit M.Z dhe bashkëshortja e tij kanë bashkëjetuar gjatë gjithë kohës me familjen e subjektit.
- Shtetasit M.Z dhe bashkëshortja rezultojnë pensionistë duke filluar nga vitet 1983 (bashkëshortja B.Z) dhe 1988 (M.Z), për pasojë të ardhurat e tyre të dokumentuara janë në masë të ulët për të financuar ndërtimin e një godine me 3 kate.

Për sa më sipër, arrihet në konkluzionin se ndërtesa 3-katëshe, në Pogradec, është financuar nga subjekti dhe bashkëshorti.

5.5 Analiza financiare

Në lidhje me koston e investimit, megjithëse është financuar nga subjekti dhe bashkëshorti, subjekti nuk ka dhënë shpjegime për periudhën e ndërtimit dhe vlerën totale të investimit në bujtinën “Z”.

Në përputhje edhe me praktikën e konsoliduar të Komisionit, për llogaritjen e kostove të ndërtimit, analiza financiare u krye duke marrë si referencë çmimet e EKB-së, ndërsa periudha e ndërtimit u përllorarit bazuar në kontratën e sipërmarrjes³¹ që z. M.Z kishte lidhur me shoqërinë “V” sh.p.k., si dhe përfundimi i ndërtimit u bazua në kohën e regjistrimit të pasurisë, pra u konsiderua si periudhë ndërtimi përgjatë viteve 2010 – 2012.

Subjekti pretendoi në përgjigjet e pyetësorit që ndërtimi ka zgjatur 3 - 4 vjet, por ky pretendim nuk u gjet i mbështetur në dokumentacionin e administruar në dosje.

Kostoja e ndërtimit, sipas EKB-së për ndërtesën 3-katëshe, shkon në shumën 10.987.678 lekë, e shtrirë në vitet, sipas tabelës vijuese.

Përshkrimi	2010	2011	2012
Sipërfaqja (m ²)	124 m ²	132 m ²	115 m ²
Çmimi sipas EKB-së (lekë/m ²)	28 665 lekë	30 094 lekë	30 094 lekë
Shuma e investimit	3 554 460 lekë	3 972 408 lekë	3 460 810 lekë
		Shuma në total	10 987 678 lekë

Me qëllim përcaktimin e vlerës së investuar të shpërndarë në vite, Komisioni u bazua në dokumentacionin e administruar në dosje, sa i përket fazave të ndërtimit të godinës dhe deklarimeve të subjektit mbi shumat e dhëna në vite vjehrrit për vitet 2010 dhe 2011. Diferenca e shumës totale të investimit u pasqyrua në analizën e vitit 2012.

Në këtë analizë financiare për këtë pasuri, nuk janë përfshirë shpenzimet e kryera për ndërtimin e pishinës apo shpenzime të tjera, të kryera në kopshtin rrethues të saj, pasi Komisioni ndodhet në kushtet e mungesës së një dokumentacioni provues të ofruar nga subjekti apo të ndonjë reference ligjore, për ta përdorur për efekt të llogaritjeve për këto shpenzime.

³¹Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 29.10.2010, nënshkruar ndërmjet porositesit M.Z dhe sipërmarrësit shoqërisë “V” sh.p.k. Koha e ndërtimit brenda një periudhe 2-vjeçare, duke filluar nga data e tërheqjes së lejes së ndërtimit.

Analiza financiare për periudhën 2010 – 2012

Përshkrimi	2010	2011	2012
Pasuri	2 260 495	85 979	3 407 375
Ndërtim i bujtinës (sipas EKB-së)	1 436 000	6 609 532	2 942 146
Diferencë likuiditeti	824 495	-6 523 553	465 229
Detyrime	-	-	-
Pasuri neto	2 260 495	85 979	3 407 375
Të ardhura	2 018 227	2 251 498	2 515 007
Të ardhura nga paga subjekti	1 169 587	1 252 032	1 272 466
Të ardhura nga pensioni M. Z	308 742	320 852	327 447
Të ardhura nga pensioni B. Z	154 122	160 050	166 212
Të ardhura nga paga bashkëshorti	295 659	518 564	748 882
Të ardhura nga interesat e depozitave në dollar	90 117		
Shpenzime	992 547	1 164 075	2 496 414
Shpenzime jetese	819 720	819 720	846 144
Shpenzim udhëtimi	108 827	249 355	808 420
Shpenzime shkollimi	64 000	95 000	108 000
Shpenzime për lindjen e vajzës Spitali Amerikan			572 852
Shpenzime për zhdoganimin e automjetit ML			110 000
Shpenzime me kartë “Raiffeisen Bank”			50 998
Rezultati financiar	-1 234 814	1 001 444	-3 388 782

Nga analiza financiare ka rezultuar pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për ndërtimin e godinës 3 kate, pasi ka një balancë negative në shumën **4.623.596 lekë**.

5.6 Përdorimi i bujtinës “Z”

Nga një kërkim i thjeshtë në gjeneruesin e të dhënave *Google*, në faqe të ndryshme ku reklamohen shërbime hotelerie, rezulton i regjistruar aktiviteti i hotelarisë bujtina “Z”. Në adresat vijuese duket sikur ky aktivitet është ushtruar/ushtrohet në pasurinë e subjektit dhe bashkëshortit.

https://www.lastminutes.deals/guest_house_z-HIEN***#gate4travel-hotel-detail-facilities

<https://www.letsbookhotel.com/en/albania/pogradec/hotel/guest-house-z.aspx>

<https://www.youtube.com/watch?v=7YL-mjcTNT0>

Subjekti, e pyetur nga Komisioni, ka shpjeguar se³² nuk ushtron dhe nuk ka ushtruar aktivitet privat në këtë pasuri. Nga kjo pasuri nuk kanë përfituar asnjëherë të ardhura, përjashtimisht produktet bujqësore kryesisht fruta dhe perime për përdorim familjar. Nuk disponojnë asnjë pasqyrë financiare pasi nuk kanë zhvilluar asnjëherë aktivitet tregtar. Ndonëse qëllimi fillestar i vjehrrit mund të ketë qenë për të zhvilluar biznes pasi qyteti i Pogradecit është destinacion turistik, ndarja e tij nga jeta dhe impenjimet e bashkëshortit e të saj, nuk e bën të mundur këtë gjë. Me rëndësi është fakti që për të vajtur te kjo pronë nuk ka infrastrukturë dhe mungesa e rrugës e bën shumë të vështirë ardhjen e ndonjë vizitori. Subjekti ka shpjeguar se familja e tyre

³²Përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 17.11.2021.

nuk ka zhvilluar aktivitet dhe, për këtë arsye, nuk ka regjistruar veprimtari tregtare që lidhen me këtë objekt, prandaj nuk ka aktivitet të regjistruar në QKR.

Lidhur me këtë pasuri, nga hetimi rezultuan disa fakte dhe rrethana:

- Kjo pasuri është reklamuar në disa faqe në internet si ofrues shërbimesh hotelerie.
- Numrat e kontaktit, të publikuara në këto faqe për këto shërbime të ofruara, rezultojnë të jenë numrat personalë të deklaruar në DPV periodike nga subjekti dhe bashkëshorti.
- Të gjitha kursimet e familjes së subjektit në vite janë përdorur për ndërtimin e pasurisë, bujtina “Z”.
- Ky aktivitet nuk është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Është i paqartë që ky investim i konsiderueshëm, i cili përfaqëson të gjitha kursimet në vite të subjektit dhe bashkëshortit deri në vitin 2010, është lënë në përdorim pa kundërshtim një personi të tretë.

Nga sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se në këtë pasuri është ushtruar aktivitet i paligjshëm në hoteleri - turizëm, me qëllim shmangie të detyrimeve tatimore.

5.7 Komisioni, për këtë pasuri, konstatoi se:

- rezultoi mungesë burimesh të ligjshme për ndërtimin e godinës 3-katëshme në shumën 4.623.596 lekë;
- subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, pasi ka deklaruar ndërtesë me sip. 124 m², ndërsa sipas lejes së ndërtimit dhe lejes së shfrytëzimit, objekti është me 3 kate, referuar vendimit nr. **, datë 29.10.2010, të KRRT-së, sipërfaqja e ndërtimit të objektit është 124 m² + 132 m² + 115 m², në total 371 m²;
- ngrihen dyshime të arsyeshme se në këtë pasuri është ushtruar aktivitet i paligjshëm hoteleri - turizëm, me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

5.8 Qëndrimi i subjektit

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e datës 25.1.2022, ka kundërshtuar metodologjinë e përdorur nga Komisioni për llogaritjen e analizës financiare, duke renditur faktet dhe provat vijuese:

i. Në kundërshtim me analizën e kryer nga Komisioni se investimi në banesën në fshatin G është shtrirë përgjatë tre viteve, rezulton sipas provave se ky investim është realizuar përgjatë viteve 2010 dhe 2011, sepse:

- kontrata e energjisë elektrike është lidhur në maj të vitit 2010;
- akt kolaudimi përcakton datën 18.10.2011, si datë të përfundimit të punimeve;
- akt piketimi datë 14.2.2011, akt kontroll mbi përfundimin e themeleve datë 26.2.2011, akt kontrolli mbi përfundimin e karabinasë datë 15.5.2011, akt kontrolli mbi përfundimin e sistemimit të ambientit datë 7.10.2011 dhe leje shfrytëzimi datë 11.11.2011;
- certifikatë për vërtetimin e pronësisë datë 1.12.2011.

Për këtë arsye, Komisioni duhet të ndryshojë vitet në të cilat ka bërë analizën financiare.

ii. Subjekti ka pretenduar se Komisioni mban qëndrim kontradiktor për llogaritjen e kostos së ndërtimit. Në përlllogaritjen e shtesës së apartamentit në pronësinë e saj dhe të bashkëshortit arsyetohet se i referohet çmimit të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave në mungesë të një situacioni punimesh. Në llogaritjen e investimit për banesën në fshatin G edhe pse ka situacion punimesh nuk e merr parasysh dhe e llogarit përsëri referuar çmimeve të EKB-së (pa specifikuar çmimet se cilit vit i referohen):

- Situacioni i punimeve është përgatitur nga shoqëria ndërtimore “V” sh.p.k. dhe për këtë situacion është lëshuar faturë tatimore datë 22.9.2011.
- BKT-ja, me shkresën e datës 27.7.2020, konfirmon pagesën për llogari të shoqërisë “V” sh.p.k. nga shtetasi K.Z në shumën 1.211.912 lekë me përshkrimin “K. Z derdh në llogari të shoqërisë likuidim fature nr. ***, për punime F/O M.Z në datën 30.11.2011”.
- Rregullimi i marrëdhënieve mes vjehrrit, si përfitues i ndërtimit dhe subjektit ndërtues që mori përsipër realizimin e tij, është kryer tej çdo ndikimi, roli apo vullneti personal të subjektit.
- Është fakt i pakundërshtueshëm që punimet e katit të parë dhe katit të dytë (papafingo) janë me konstruksion të lehtësuar në masën 100 % dru dhe ky fakt provohet me: fotot e ndërtesës, të cilat janë vënë në dispozicion të Komisionit, i cili i ka administruar edhe në korrespondencën me ILDKPKI-në, vënë në dispozicion më 31.3.2016, prej saj; faktin që i gjithë ndërtimi ka përfunduar për një periudhë kohore një vit; kati i parë dhe kati i dytë (papafingo) nuk janë regjistruar në ZVRPP-në Pogradec, pasi ndërtime të tilla janë konceptuar nga institucioni publik konstruksione të lehta.

Nisur nga sa më sipër, metodologjia e përdorur nga Komisioni për të përlllogaritur vlerën e investimit është e gabuar.

Subjekti ka vënë në dispozicion aktekspertimin, e kryer nga eksperti vlerësues i pasurive të paluajtshme për përlllogaritjen e kostos së ndërtimit të objektit. Për shkak të specifikave të këtij ndërtimi, që katet e sipërme janë të përbëra me konstruksion druri, eksperti ka vlerësuar që ndërtimi i këtij objekti është në vlerën totale 7.801.662 lekë, ku në të ka përfshirë edhe TVSH-në. Gjithashtu, subjekti pretendon se edhe nëse do të llogaritet kostoja e ndërtimit e shtëpisë 3-katëshe sipas çmimeve të EKB-së duhet t'i hiqet 20% vlera e TVSH-së dhe 5% fondi rezervë.

Ndërkohë, subjekti, për herë të parë në prapësime, ka pretenduar se investimi i kryer ka kushtuar 8.000.000 lekë, fakt ky i padeklaruar asnjëherë gjatë hetimit.

iii. Subjekti ka pretenduar se ka deklaruar në kohë reale investimet e kryera:

- shumën 1.436.000 lekë që i ka dhënë vjehrrit në DPV-në e vitit 2010;
- shumën 62.000 USD që i ka dhënë vjehrrit në DPV-në e vitit 2011;
- ka të përshkruar në veprimin bankar faktin se tërheqja e lekëve në “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 1.9.2011, është bërë me qëllim “për investim në një pronë të vjehrrit”;
- koha e tërheqjes së kursimeve në bankë përkon me kohën në të cilën është bërë investimi.

iv. Subjekti ka pretenduar se Komisioni duhet të përfshijë në analizën financiare si të ardhur të ligjshme bonusin e transportit të përfituar në vite prej saj, në periudhën 2010 – 2013, afërsisht 420.000 lekë/vit. Subjekti ka shpjeguar se gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës, si Drejtuese e Prokurorisë, ka banuar në qytetin e Pogradecit dhe banesa me institucionin e Prokurorisë, është në distancën 1.5 km larg. Udhëtimet për në Tiranë për shkak të funksionit, ishin mesatarisht 1 herë në muaj. Për këto arsye, këto të ardhura në atë periudhë janë të ligjshme dhe duhet të merren në konsideratë prej Komisionit, duke përfshirë në analizë bonusin e transportit në shumën 1.377.293 lekë.

v. Shpenzimet e udhëtimeve

Subjekti ka kundërshtuar shpenzimet e llogaritura nga Komisioni në analizën financiare për udhëtimet e saj jashtë shtetit, duke argumentuar se për udhëtimet në Greqi është akomoduar te familjarët e saj, prindërit, motrat dhe tek i vëllait (në Qipro). Për këto arsye, analiza financiare e Komisionit duhet të ribëhet duke mbajtur në konsideratë faktet konkrete.

vi. Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, pasi ka deklaruar ndërtesë me sip. 124 m², ndërsa ka të bëjë me objekt me 3 kate, me sipërfaqe totale 371 m², subjekti ka pretenduar se deklarimi është bërë sipas statusit juridik të pronës sipas regjistrimit të saj në ZVRPP. Pra, mbi bazën e dokumentacionit ligjor të pronës, certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, datë 10.2.2015, rezulton se pasuria me nr. ***, vol. *, f. ***, z.k. 1903 e llojit “truall” me sip. 220 m² ka të regjistruar ndërtesë me sip. 124 m².

Nga subjekti nuk është bërë asnjë deklaram i pasaktë apo fshehje/ndryshim në deklaram sa kohë bashkëshorti i referohet një dokumenti ligjor siç është dokumenti i pronësisë. Në dijeninë e tyre, ky pasqyrim nuk është bërë për arsye se kati i parë dhe kati i dytë (papafingo) janë konstruksione të lehta - 100% druri dhe këto lloje konstruksionesh nuk pasqyroheshin në certifikatën e pronësisë, referuar konceptit juridik të pasurisë së paluajtshme. Ky fakt (pra ndërtesë tre kate) është pasqyruar në kartelën e pronësisë të seksioni “përshkrim i veçantë”, e cila është vënë në dispozicion të hetimit.

vii. Në lidhje me ushtrimin e aktivitetit hoteleri – turizëm, subjekti ka pretenduar se asnjëherë as bashkëshorti i saj dhe as vjehri nuk kanë ushtruar aktivitet në këtë pasuri. Ky fakt provohet nga institucionet:

- QKB-ja, ku nuk rezulton një aktivitet i regjistruar;
- vërtetimi i datës 1.12.2021, lëshuar nga Bashkia Pogradec, Njësia Administrative B, me të cilin vërtetohet se bazuar në verifikimet e bëra dhe në terren, nuk është përdorur apo regjistruar për aktivitet tregtar;
- vërtetimi nr. ***, datë 6.12.2021, lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Pogradec në përmbajtje të të cilit thuhet se kjo ndërtesë nuk është përdorur dhe/apo regjistruar asnjëherë për aktivitet tregtar.

Nëse në ndërtesën bujtina “Z” do të zhvillohej një aktivitet tregtar, sipas dyshimeve të Komisionit, do të ishin në formën e një bujtine të tillë. Subjekti ka pretenduar se kjo është e pamundur pasi:

- nuk kanë aplikuar asnjëherë për certifikatë klasifikimi si strukturë akomoduese;

- nuk disponojnë asnjë lloj regjistrimi për qëllime aktiviteti privat në QKB;
- bashkëshorti dhe subjekti janë të punësuar në qytetin e Tiranës dhe lëvizin vetëm në raste festash apo pushimesh për në qytetin e Pogradecit çka e bën të pamundur ushtrimin e një biznesi të tillë;
- referuar dokumentit të lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), konsumi mesatar i energjisë elektrike për këtë ndërtesë është në shumën 4.400 lekë/muaj për periudhën 2010 – dhjetor 2021, i cili nuk justifikon një bujtinë që u ofron bujtësve të saj akomodim dhe ushqim dhe prova e shpenzimit të energjisë elektrike është një fakt i pamohueshëm lidhur me destinacionin vetëm familjar të ndërtimit (bashkëlidhur historiku i pagesave të energjisë elektrike nga momenti i lidhjes së kontratës datë 20.5.2010);
- publikimi i kësaj godine në faqen *online* është reklamuar nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2015 pasi ka qenë i papunë. Ai hoqi dorë shpejt nga kjo ide pasi iu desh të qëndronte në Tiranë për t’i shërbyer nënës së tij, e cila ishte në kushte tepër të rënda shëndetësore deri sa ndërroi jetë (familja e subjektit ka jetuar nga muaji janar 2014 e në vijim në Tiranë, së bashku me subjektin dhe bashkëshortin jetonin edhe prindërit e bashkëshortit deri kur ndërroan jetë).

Ky reklamim nuk ka asnjë historik, nuk ka akses për të rezervuar *online* dhe duket qartazi që i mungojnë të dhëna që mundësojnë aksesimin apo rezervimin në të. Në lidhje me këtë reklamim nuk ka asnjë koment vlerësues nga turistë potencialë (asnjë koment, asnjë *review*, asnjë përditësim). Nëse do të kishte rezervim *online* dhe do të ishte funksionale kjo adresë, këto rezervime do të ishin evidentuar në llogarinë bankare të bashkëshortit apo në çdo llogari tjetër, të cilat janë hetuar nga Komisioni. Nga hetimi nuk rezulton asnjë pagesë që të hedhë hije dyshimi se mund të jetë pagesa për aktivitet “hoteleri” a ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm.

5.9 Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, mbështetur në gjithë dokumentacionin e administruar në dosje, analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti në seancë dëgjimore dhe pretendimet e saj duke arsyetuar si vijon:

i. Në lidhje me periudhën e ndërtimit të godinës 3-katëshe, në përgjigje të pyetësorit ka shpjeguar³³ se punimet për ndërtimin e godinës kanë filluar në vitin 2010 dhe kanë vazhduar për rreth 3-4 vjet, Komisioni ka marrë në konsideratë provat dhe faktet e evidentuara nga subjekti, të cilat janë treguese se ndërtimi mund të jetë kryer në vitet 2010 - 2011. Përfundimisht, Komisioni ka rikryer analizën financiare, duke e shtrirë vetëm në këto 2 vite.

ii. Në lidhje me koston e ndërtimit të godinës 3-katëshe, nisur nga disa rrethana faktike si:

- rezulton e provuar se një pjesë e ndërtimit të kryer nga vjehri i subjektit është me dru;
- nuk rezultojnë çmime reference sipas EKB-së apo referenca të tjera zyrtare për ndërtime të kombinuara gurë dhe dru;
- subjekti ka deklaruar në kohë reale, në DPV-të e viteve 2010 dhe 2011, investimin e kryer në këtë pasuri që është pak a shumë sa vlera e investimit e pretenduar nga subjekti dhe Komisioni, nisur nga sa me sipër, ka çmuar të drejta pretendimet e subjektit, duke llogaritur

³³Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021.

koston e investimi të ndërtesës 3 kate, në vlerën 8.000.000 lekë dhe analiza financiare u rillogarit për vitet 2010 – 2011.

iii. Komisioni, duke marrë në konsideratë qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, për këtë çështje, nuk ka konsideruar bonusin e transportit si të ardhur të ligjshme, dhe si të tillë, nuk e ka përfshirë në analizën financiare. Nga ana tjetër, Komisioni nuk i ka llogaritur subjektit, shpenzime transporti. Për pasojë analiza financiare për këtë element të pretenduar nga subjekti, nuk pësoi ndryshime.

iv. Komisioni, në lidhje me shpenzimet e udhëtimeve sipas të dhënave të marra nga sistemi TIMS, bazuar në aktet e administruara në prapësime, ka çmuar të drejtë pretendimin e subjektit, duke reflektuar në analizën financiare ndryshimet përkatëse.

Trupi gjykues, duke rikonsideruar vlerësimet paraprake të Komisionit, sa më sipër u argumentua, ka reflektuar në analizë financiare ndryshimet përkatëse sipas tabelës vijuese.

Analiza financiare pas prapësimeve për godinën 3 kate

Përshkrimi	2010	2011
Pasuri	2 260 495	85 979
Ndertim i Bujtines	1 436 000	6 609 532
Diferencë Likuiditeti	824 495	-6 523 553
Likuiditete në fund të vitit	7 324 024	800 471
Gjendje Cash	764 000	800 000
Likuiditete ne banke	6 560 024	471
Detyrime	-	-
Pasuri neto	2 260 495	85 979
Të ardhura	2 273 824	2 251 498
Të ardhura nga paga Subjekti	1 169 587	1 252 032
Të ardhura nga paga b/shorti	551 256	518 564
Të ardhura nga pensioni i M. Z	308 742	320 852
Të ardhura nga pensioni i B. Z	154 122	160 050
Te ardhura nga interesat e depozitave	90 117	
Shpenzime	992 547	1 859 616
Shpenzime jetese	819 720	819 720
Shpenzim udhetimi	108 827	180 896
Shpenzime shkollimi	64 000	95 000
Shpenzime te tjera		764 000
Rezultati financiar	-979 217	305 902

- Për sa më sipër, rezulton se subjekti është në mungesë burimesh të ligjshme për investimin e kryer në ndërtesën 3 kate, në shumën 979.217 lekë.

v. Në lidhje me mosdeklarimin e saktë të sipërfaqes totale të ndërtimit nga bashkëshorti i subjektit, Komisioni arsyeton se megjithëse është një pasaktësi në deklarim, nuk është një veprim që mund të penalizojë subjektin, për aq kohë sa të gjitha aktet e dosjes së regjistrimit të pasurisë referojnë që ndërtesa është 3 kate, me sip. 124 m². Ky fakt është i cituar edhe në

kartelën e pasurisë, ku citohet ndërtesë 3 kate. Komisioni, në këtë proces rivlerësimi, kontrollon vërtetësinë e deklarimeve të subjektit krahasuar kjo me aktet ligjore dhe, për këtë shkak, ka konstatuar pasaktësinë e deklaruar nga personi i lidhur, fakt i cili nuk e penalizon subjektin në vlerësimin tërësor për sa i përket kriterit të pasurisë.

vi. Në lidhje me bujtinën “Z” shpjegimet e dhëna në prapësime për mosushtrim të aktivitetit privat të hotelerisë, Komisioni vlerëson se subjekti nuk provoi të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, që në këtë pasuri ushtrohej një aktivitet i ligjshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi, si regjistrimi në QKB, sipas ligjit nr. 9901/2008, “Për tregtarët e shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, në Tatime, Bashki dhe në Ministrinë e Turizmit, referuar ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”.

Në konkluzion, trupi gjykues, nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme për investimin në ndërtesën 3 kate, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3, të neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar investimin e kryer.

6. Tokë³⁴ e llojit “pyll” me sip. 6.500 m², në Pogradec

Vlera e deklaruar: nuk është deklaruar vlerë.
Pjesa në përqindje: 100% në pronësi të bashkëshortit të subjektit.
Burimi i krijimit: përfituar me çeljen e dëshmisë së trashëgimisë testamentare nga babai.
Deklarimi në DPV: e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se ka përfituar pasuri nga babai i tij pas çeljes së dëshmisë testamentare.
Mënyra e fitimit: kaluar në pronësi të z. K.Z pas çeljes së dëshmisë testamentare të z. M. Z(babai) me nr. ***, datë 22.1.2015, regjistruar në ZRPP-në Pogradec, më 10.2.2015 (L i Ç, Pogradec).

6.1 Hetimi i Komisionit

ZQRPP-ja³⁵ ka konfirmuar se në emër të shtetasit K.Z rezultoi pasuria “pyll” me sip. 6.500 m². Bashkëlidhur shkresës ndodhen certifikatat e pronësisë, kartelat, hartat treguese të pasurisë së mësipërme, si dhe dëshmia e trashëgimisë testamentare dhe ligjore nr. ***, datë 22.1.2015.

ZVRPP-ja Pogradec³⁶ ka bashkëlidhur:

- certifikatë për vërtetim pronësie datë 10.5.2006, të pasurisë “pyll” në G, Pogradec, regjistruar me nr. ***, sip. 65.000 m², në bashkëpronësi të familjarëve Z, ku shtetasit M. Z i takon 4/20 pjesë;
- aktmarrëveshje pjesëtimi vullnetar nr. ***, datë 28.6.2006, në të cilën bashkëpronarët e pasurive nr. ***, ***, *** dhe *** kanë rënë dakord për ndarjen e tyre. Sipas kësaj marrëveshjeje, pas ndarjes, shtetasi M.Z përfiton në pasurinë nr. ***, sip. 13.000 m²;

³⁴Bashkëlidhur deklaratës certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 10.2.2015, të pasurisë “pyll” me sipërfaqe totale 6.500 m², regjistruar me nr. ***, në emër të shtetasit K.Z, me vendndodhje në G, Pogradec. Bashkëlidhur ndodhet harta treguese dhe kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilën evidentohet kalimi i pronësisë në emër të shtetasit K. Z, më 22.1.2015, me dëshmi trashëgimie. Data e regjistrimit fillestar të pasurisë më 10.7.2009, në emër të shtetasit M. Z, përfituar me ndarje pasurie.

³⁵Shkresë nr. ***, datë 4.10.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRPP-së Pogradec, drejtuar ILDKPKI-së.

³⁶Me e-mail-in e datës 7.9.2018, drejtuar ILDKPKI-së.

- certifikatë për vërtetim pronësie datë 10.8.2006, të pasurisë “pyll” në G, Pogradec, regjistruar me nr. ***, sip. 13.000 m², në emër të shtetasit M.Z;
- urdhër nr. **, datë 10.7.2009, nga ZVRPP-ja Pogradec, për ndarjen e pasurisë nr. ***, në z. k. ***, në G, me sip. 13.000 m², në pasuritë nr. ***, me sip. 6.500 m² dhe nr. ***, me sip. 6.500 m².

- **Nga verifikimi i akteve nuk rezultuan problematika.**

7. Automjet³⁷ tip “F- R”, vit prodhimi 2004, me targa AA *** GR

Vlera e deklaruar: 1.500 euro.

Pjesa në përqindje: 100% në pronësi të bashkëshortit të subjektit.

Burimi i krijimit: nuk është deklaruar burim krijimi në deklaratën *Vetting*.

Deklarimi në DPV³⁸: si burim janë deklaruar “të ardhurat”.

Mënyra e fitimit: blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 29.8.2013.

7.1 Hetimi i Komisionit

DPSHTRR-ja³⁹ ka konfirmuar se automjeti me targa AA *** GR është në pronësi të shtetasit K. Z. Bashkëlidhur shkresës ndodhen leja e qarkullimit rrugor të automjetit dhe kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 29.8.2013.

Në sistemin e AMF-së verifikohet se bashkëshorti i subjektit e ka ende këtë automjet dhe figuron si pronar dhe përdorues i saj. Bashkëshorti i subjektit i ka blerë në mënyrë të rregullt policat e sigurimit të detyrueshëm për këtë automjet.

7.2 Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare për periudhën janar – gusht 2013 për të vlerësuar nëse subjekti dhe bashkëshorti kishin mundësi të blinin automjetin me pagat e kësaj periudhe. Subjekti ka pasur gjendje *cash* të deklaruar për vitin 2012, por rezulton se nuk ka deklaruar pakësim të kësaj gjendjeje, madje ka deklaruar shtesë të kursimeve.

Për këtë arsye, Komisioni arriti në përfundimin se automjeti është krijuar nga të ardhurat janar – gusht 2013, sikurse paraqitet në tabelën vijuese.

Përshkrimi	Periudha janar - gusht 2013
Pasuri	581 008
Automjet tip “F.R”, datë 29.8.2013	316 837
Diference likuiditeti	264 171
Detyrime	0
Pasuri neto	581 008
Të ardhura	2 125 441
Të ardhura nga pensioni M. Z	328 579
Të ardhura nga pensioni B. Z	114 717

³⁷Bashkëlidhur deklaratës: kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 29.8.2013, me palë shitëse D.T (letërmjofim I***E), dhe palë blerëse K.Z të automjetit tip “F. R”, me targa KZT *** në vlerën 1.500 euro, paguar para redaktimit të kontratës dhe jashtë zyrës noteriale; certifikata e pronësisë së mjetit rrugor me targa AA *** GR, lëshuar në datën 2.9.2013, e automjetit tip “F.R”, vit prodhimi 2004, në pronësi të shtetasit K.Z. Pronësia mbi mjetin është fituar nëpërmjet aktit nr. ***, datë 29.8.2013; leja e qarkullimit të mjetit me targa AA *** GR.

³⁸E vitit 2013.

³⁹Shkresë nr. *** prot., datë 3.8.2020.

Të ardhura nga paga subjekti	866 651
Të ardhura nga paga bashkëshorti	815 494
Shpenzime	1 689 241
Shpenzime jetese	564 096
Shpenzim udhëtimi	736 243
Shpenzime shkollimi	108 000
Shpenzime për zhdoganimin e automjetit ML	110 000
Shpenzime me kartë “Raiffeisen Bank”	170 902
Rezultati financiar	-144 808

7.3 Komisioni, për këtë pasuri, konstatoi se:

- nga analiza e kryer për blerjen e automjetit ka rezultuar një balancë negative në shumën **144.808 lekë**;
- çmimi i blerjes së automjetit, referuar kontratës së shitblerjes, duket i ulët.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

7.4 Qëndrimi i subjektit

Subjekti, në prapësimet e depozituara, ka pretenduar se analiza e Komisionit për automjetin nuk është e saktë, pasi për blerjen e automjetit është përdorur gjendja *cash*, që dispononte në fund të vitit 2012. Në vijim, me të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2013, e ka zëvendësuar gjendjen e kursimeve *cash* që përdori për blerjen e automjetit, duke mos pasur pakësim të gjendjes *cash* në fund të vitit 2013.

7.5 Vlerësimi i Komisionit

Komisioni, pas analizimit të pretendimeve të subjektit, konstaton se megjithëse subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për automjetin, që është një pasaktësi në plotësimin e deklaratës, shpjegimi i dhënë prej saj u çmua bindës për Komisionin.

Duke e konsideruar si të tillë, analiza financiare, pas prapësimeve, ka rezultuar pozitive.

8. Automjet⁴⁰ tip “J. M-Benz ML ***”, me targa AA *** EF, vit prodhimi 2002

Vlera e deklaruar: 4.000 USD.

Pjesa në përqindje: 100% në pronësi të bashkëshortit të subjektit.

Burimi i krijimit: nuk është deklaruar burim krijimi.

Deklarimi në DPV⁴¹: nuk është deklaruar burim krijimi.

Mënyra e fitimit: blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 6.4.2009.

8.1 Hetimi i Komisionit

DPSHTRR-ja⁴² ka konfirmuar se automjeti me targa AA *** EF është në pronësi të shtetasit K.Z. Bashkëlidhur shkresës ndodhet leja e qarkullimit rrugor të automjetit.

⁴⁰Bashkëlidhur deklaratës: certifikata e pronësisë së automjetit rrugor tip “Mercedes-Benz ML ***”, me targa AA *** EF, lëshuar në datën 14.8.2012, vit prodhimi 2002, në pronësi të shtetasit K. Z. Pronësia mbi automjetin është fituar nëpërmjet aktit të datës 14.8.2012; leja e qarkullimit të automjetit me targa AA *** EF.

⁴¹DPV e vitit 2009.

⁴²Me shkresën nr. *** prot., datë 3.8.2020.

Deklarata e zhdoganimit, datë 13.8.2012, nga dogana e Qafë Thanës, palë eksportuese I. R, të automjetit tip “Mercedes-Benz”, vlerë të faturuar 2.500 euro. Shuma e detyrimeve të paguara në doganë: 103.620 lekë.

Certifikata e titullarit/pronarit të automjetit, në pronësi të shtetasit K.Z. Përkthyer nga dokumenti origjinal sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 12.8.2012.

Në sistemin e AMF-së verifikohet se bashkëshorti i subjektit e ka ende këtë automjet dhe figuron si pronar dhe përdorues. Bashkëshorti i subjektit ka blerë në mënyrë të rregullt policat e sigurimit të detyrueshëm për automjetet.

Subjekti ka shpjeguar⁴³ se burimi i krijimit të shumës 4.000 USD, për blerjen e automjetit, kanë qenë kursimet e saj dhe të bashkëshortit të deklaruar në vitet 2008 dhe 2009 sipas DPV-ve.

8.2 Analiza financiare

Duke qenë se subjekti në DPV-në e vitit 2008 nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*, si dhe në vitin 2009 nuk ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri, Komisioni vlerësoi që të analizojë periudhën janar – 6 prill 2009, kur është blerë automjeti, për të vlerësuar nëse subjekti dhe bashkëshorti kishin mundësi të blinin automjetin me pagat e kësaj periudhe, siç paraqitet në tabelën vijuese.

Përshkrimi	Viti 2009
Pasuri	454 314
Automjet ML, datë 6.4.2009	375 920
Diferencë likuiditeti	78 394
LIKUIDITETE (fundviti dok.)	6 409 988
Gjendje <i>cash</i>	700 000
Likuiditete në bankë	5 709 988
Detyrime	
Pasuri <i>neto</i>	454 314
Të ardhura	665 954
Të ardhura nga paga e subjektit	357 362
Të ardhura nga pensioni M. Z	64 731
Të ardhura nga pensioni B. Z	36 907
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	206 954
Shpenzime	325 163
Shpenzime jetese	204 930
Shpenzime udhëtimi	95 333
Shpenzime shkollimi	24 900
Rezultati financiar	-113 523

8.3 Komisioni, për këtë pasuri, konstatoi se:

- Subjekti ka rezultuar me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit në shumën **113.523 lekë**.

⁴³Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

8.4 Qëndrimi i subjektit

Subjekti, në prapësime, ka shpjeguar se edhe pse prej saj nuk është deklaruar se si burim për blerjen e automjetit është përdorur gjendja *cash* që dispononte deri në vitin 2008 për blerjen e këtij automjeti, ajo e ka përdorur gjendjen *cash*. Në vijim, me të ardhurat e realizuara në vitin 2009, e ka zëvendësuar gjendjen e të ardhurave *cash* që ka përdorur për blerjen e automjetit, duke mos pasur ndryshime në fund të vitit.

8.5 Vlerësimi i Komisionit

Nga shqyrtimi i analizës financiare për vitin 2009, duket se subjekti ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të krijuar gjendjen *cash*. Shpjegimet e subjektit ishin bindëse dhe pasi u pranuan nga trupi gjykues, përfundimisht ka rezultuar një balancë pozitive.

9. Llogari rrjedhëse⁴⁴ në shumën 2.099.923 lekë, në emër të shtetasit K. Z

Burimi i krijimit: të ardhura të kaluara nga ekzekutimet e vendimeve gjyqësore nr. **, datë 13.2.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe nr. **, datë 24.2.2015, si dhe pagesat si ekspert, të kaluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore Tiranë, Elbasan dhe Kurbin nga puna si ekspert autoteknik, të pasqyruara në faqen 4 të deklaramit.

Deklarimi në DPV: në DPV-të e viteve 2014 dhe 2015 subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore nr. **, datë 13.2.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe nr. **, datë 24.2.2015.

9.1 Hetimi i Komisionit

“Raiffeisen Bank”⁴⁵ ka konfirmuar llogari page në emër të shtetasit K. Z, me gjendjen sipas deklaramëve të subjektit.

Në dosjen e hetimit janë administruar aktet, si:

- vendimi nr. **, datë 13.2.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për detyrimin e palës së paditur ALUIZNI t’i paguaj paditësit K.Z shumën totale prej 1.365.000 lekësh, si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës;
- vendimi nr. **, datë 24.2.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë t’i paguaj paditësit K. Z dëmshpërblimet që rrjedhin nga zgjidhja e marrëdhënieve të punës në vlerën e 16 pagave mujore *neto*.

⁴⁴Bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogarie bankare në emër të shtetasit K.Z, pranë “Raiffeisen Bank”, për periudhën 1.1.2016 – 23.1.2017. Gjendja në llogari në datën 19.1.2017, në shumën 2.099.923 lekë. Referuar veprimeve në llogari, evidentohen kreditime në favor të shtetasit K. Z, në shumat 179.010 lekë, datë 22.4.2016; 10.200 lekë dhe 124.950 lekë, datë 28.6.2016 dhe 20.400 lekë, datë 30.12.2016. Transferrat kanë përshkrimin “pagesa dhe honorare”; vendim nr. **, datë 13.2.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për detyrimin e palës së paditur ALUIZNI t’i paguaj paditësit K. Z shumën totale prej 1.365.000 lekësh si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës; si dhe vendim nr. **, datë 24.2.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, për detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë t’i paguaj paditësit K.Z dëmshpërblimet që rrjedhin nga zgjidhja e marrëdhënieve të punës në vlerën e 16 pagave mujore *neto*. Duke iu referuar konfirmimit nga ISSH-ja, paga mujore *neto* është në vlerën rreth 58.000 lekë. Dëmshpërblimi në vlerë të përafërt rreth 928.000 lekë.

⁴⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2020.

- Nga verifikimi i kryer nuk u evidentuan problematika.

10. Të ardhurat e krijuara në SHBA

Subjekti, në vite, ka deklaruar të ardhura nga punësimi i saj dhe i bashkëshortit në SHBA, në shumën 49.000 USD, si vijon:

- në DPV-në e vitit 2004 – paga e bashkëshortit si emigrant në SHBA, në shumën 35.000 USD (kamerier në *G.C.C. F*;
- në DPV-në e vitit 2007: (i) 5.000 USD të përfituara nga punësimi në shoqërinë “S C” për periudhën prill – korrik 2007; dhe (ii) 4.000 USD të përfituara nga punësimi i bashkëshortit në shoqërinë “A.C” në periudhën prill – korrik 2007;
- në DPV-në e vitit 2009 – 5.000 USD të përfituara nga punësimi i subjektit në shoqërinë “A. C” në gusht të vitit 2009.

Subjektit i është kërkuar nga Komisioni që të japë informacione për periudhën e qëndrimit në SHBA, të dokumentojë punësimin e saj dhe të bashkëshortit gjatë kësaj kohe, si dhe të provojë që ka marrë autorizim nga Prokuroria e Përgjithshme për të lejuar punësimin e saj në SHBA.

Subjekti ka shpjeguar⁴⁶ se *bashkëshorti ka qëndruar në SHBA gjatë viteve 2002, 2003 dhe 2004, ndërsa ajo ka qëndruar për periudhën korrik – gusht 2002 dhe gjatë lejeve vjetore të viteve 2003 dhe 2004*. Gjithashtu, ka sqaruar se kanë udhëtuar gjatë viteve 2005 dhe 2006. Në vitin 2007 subjekti ka qëndruar disa muaj pasi ka qenë me leje lindjeje.

Subjekti është larguar nga Shqipëria në fund të marsit të vitit 2007, në datën 13.4.2007 ka lindur vajzën R. Z dhe është kthyer në korrik të vitit 2007. Bashkëshorti i saj K.Z ka qëndruar për një periudhë afro 40-ditore me dy qëndrime, fillimisht e ka shoqëruar kur ka lindur dhe herën e dytë, në muajin korrik, me qëllim për t’u kthyer familjarisht në Shqipëri. Gjithashtu, në vitin 2009 ka qëndruar një muaj në SHBA gjatë lejes vjetore.

Subjekti ka pretenduar se gjatë qëndrimit në SHBA ka ndjekur kurse kualifikimi në “*F. C. C*” në J, në lidhje me dhunën në familje dhe në fushën e shëndetësisë, për të cilat është certifikuar (dokumente të cilat i ka depozituar të përkthyer dhe të noterizuara). Gjatë qëndrimit në SHBA ka ndihmuar miqtë e saj, duke u përkujdesur për të afërmit e tyre që kanë pasur nevojë në fushën e shëndetësisë, për shkak të kualifikimit të saj në këtë drejtim, të cilët e kanë shpërblyer në vlera modeste që i ka deklaruar si të ardhura. Gjithashtu i ka ndihmuar në punët e tyre, pasi kanë pasur firma pastrimi dhe mirëmbajtjeje, të cilat janë të deklaruara periodikisht. Subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur dhe nuk ka kërkuar ndonjë autorizim nga Prokuroria e Përgjithshme sepse nuk e ka ndërprerë asnjëherë marrëdhënien e punës. Bashkëshorti ka qenë i punësuar në punë të ndryshme gjatë gjithë kohës së qëndrimit në SHBA për të përballuar nevojat e familjes, të deklaruara sipas DPV-ve. Gjithashtu, përveç të ardhurave nga punësimi ku bashkëshorti paguhej me çek për shkak të punës si kamerier në *J, G.C.C*** H.C.R*, siguronte të ardhura edhe nga bakshishet që fitonte në punën e përditshme, të cilat merreshin *cash*.

⁴⁶Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021.

Subjekti ka depozituar dokumente provuese për të ardhurat e realizuara në SHBA⁴⁷.

Në tabelën vijuese janë pasqyruar të ardhurat në vite

Vitet	2002	2003	2004	2007	2009	Total
Shuma e provuar me dokumentacion (USD)	756	7.465	2.085	5.877		16.182
Shuma e deklaruar në DPV (USD)			35.000	9.000	5.000	49.000

Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, rezultoi se ajo ka provuar me dokumentacion shumë 16.182 USD, shumë për të cilën janë paguar edhe taksat në SHBA. Për efekt të analizës financiare kjo shumë është konsideruar si e ardhur e ligjshme e krijuar nga subjekti dhe bashkëshorti dhe, për pasojë, është përfshirë në analizën financiare të kryer nga Komisioni sipas viteve përkatëse.

10.1 Komisioni, për këtë pasuri, konstatoi se:

- Në lidhje me të ardhurat e deklaruar në deklarimet periodike vjetore si të realizuara në SHBA, subjekti nuk ka provuar burimet e ligjshme që kanë shërbyer në krijimin e shumës 32.818 USD, si të përfituar nga emigracioni në SHBA, fakt për të cilin subjektit iu kalua barra e provës.

10.2 Qëndrimi i subjektit

Subjekti, në prapësime, ka pretenduar se është në pamundësi objektive për të mundësuar dokumentacion të plotë, pasi kanë kaluar 20 vjet. Ajo pretendon se të ardhurat nga puna e bashkëshortit gjatë viteve 2002 – 2004 janë në shumën 35.000 USD, të cilat duhet të përfshihen në analizë, të ardhura që janë përdorur për krijimin e depozitës në vitin 2004. Subjekti ka shpjeguar se përveç të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit si kamerier, kishte përfituar edhe të ardhura nga bakshishet, për të cilat nuk disponohet dokumentacion. Për këtë arsye Komisioni duhet të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortit në SHBA, në shumën e deklaruar prej subjektit.

Subjekti ka pretenduar si të ardhur të ligjshme edhe një shumë të depozituar në bankë me çek në vitin 2004, në shumën rreth 276.000 lekë, si kompensim nga shteti amerikan për taksat e paguara.

10.3 Vlerësimi i Komisionit

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk solli prova të reja për të ndryshuar konstatimet e Komisionit në lidhje me të ardhurat e deklaruar nga subjekti si të përfituara nga punësimi i saj dhe i bashkëshortit në SHBA. Subjekti, si gjatë hetimit, ashtu edhe pas kalimi të barrës së provës, provoi punësimin e bashkëshortit në SHBA, por referuar dokumentacionit të depozituar nuk u provuan të ardhurat e ligjshme në masën e pretenduar nga subjekti. Për pasojë, në

⁴⁷W-2 Wage and Tax Statement 2002 për K.Z si i punësuar në J. G. C. C *** H.C.R (origjinali përkthyer dhe noterizuar); W-2 Wage and Tax Statement 2003 për K.Z si i punësuar në J.G. C. C *** H.C.R (origjinali përkthyer dhe noterizuar); W-2 Wage and Tax Statement 2004 për K.Z si i punësuar në J.G.C. C*** H.C.R (origjinali përkthyer dhe noterizuar); W-2 Wage and Tax Statement 2004 për K. Z si i punësuar në J. G.C.C *** H. C. R (origjinali përkthyer dhe noterizuar); formular **C US Individual Income Tax Return 2007 (origjinali përkthyer dhe noterizuar).

analizën financiare të kryer nga Komisionit janë përfshirë vetëm të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit për të cilat ishin paguar tatimet, në përputhje me parashikimin e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës.

Në lidhje me pretendimin e subjektit se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar burimet e ligjshme, Komisioni arsyeton se subjekti duhet t'i provonte Komisionit se dokumenti që provon të ardhurat e tij e ligjshme është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri apo nuk mund të merret në rrugë tjetër. Nga aktet e depozituara nga subjekti rezultoi se provuar që bashkëshorti ishte i punësuar për periudha të shkurtra për vitet 2002 – 2004 dhe 2007 pranë “G.C.C” F, por në dokumentet që ka vënë në dispozicion nuk rezultoi se provuar se çfarë pune ka bërë. Për periudhën e punësuar të ardhurat e realizuara janë në shumën 16.182 USD. Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga “bakshishet” si kamerier, sikurse pretendon subjekti, këto të ardhura nuk mund të provohen me dokumentacion.

Pra, me aktet që disponohen provohet punësimi dhe të ardhurat përkatëse, por nuk provohen të ardhurat në masën e deklaruar nga subjekti. Për pasojë, pretendimi i subjektit që është në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar të ardhurat e ligjshme të bashkëshortit, nuk është bindës për Komisionin.

Për sa kohë nuk është depozituar dokumentacion provues për pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara si të realizuara në SHBA, këto të ardhura nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se të ardhurat e krijuara nga punësimi në SHBA i bashkëshortit, të cilat përmbushin standardet e ligjshmërisë, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, nuk përputhen në vlerë me të ardhurat e deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *Vetting*.

Deklarimi i subjektit në këtë rast u vlerësua nga trupi gjyqës si deklaram i pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, referuar parashikimit të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

11. Në lidhje me shumën 20.000 USD të prindërve të subjektit

Në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2004, subjekti ka deklaruar depozitë në B.A në shumën 41.417 USD, nga e cila 20.000 USD u përkasin prindërve emigrantë në Greqi.

11.1 Hetimi i Komisionit

Subjekti ka shpjeguar në DPV-në e vitit 2004 që shuma 20.000 USD është e prindërve të saj K dhe V.K, emigrantë në Greqi.

Nga verifikimi i deklaratave ka rezultuar se subjekti, në vitet vijuese, ka deklaruar të ardhura nga interesat e depozitës në USD, duke deklaruar bashkëpronësinë e këtyre të ardhurave në masën 50% me bashkëshortin e duke mos i përmendur prindërit. Në vijim, subjekti nuk ka deklaruar që këto shuma t'i jenë kthyer prindërve të saj.

Gjithashtu, subjekti, në deklaratën *Vetting*, nuk ka deklaruar detyrimin ndaj prindërve në shumën 20.000 USD.

Referuar dokumentacionit të administruar në ILDKPKI, subjekti ka derdhur në depozitë në datën 24.8.2007, në një shumë të vetme prej 58.985 USD pranë B. A (Intesa Sanpaolo Bank). Depozita është maturuar deri në datën 1.9.2011, kur është kryer transferimi në llogari dhe më pas tërheqja totale e shumës 62.900 USD.

Komisioni i ka kërkuar subjektit të saktësojë nëse paratë e prindërve të depozituar në emër të saj janë një dhurim i tyre, si dhe të provojë burimet e ligjshme të prindërve për krijimin e këtyre shumave.

Subjekti ka shpjeguar⁴⁸ se: *“Në vitin 2003 – 2005 familja prej pesë anëtarësh ka banuar në një sipërfaqe afërsisht 60 m². Ishim në atë kohë duke planifikuar mundësinë për të blerë një apartament më të madh në sipërfaqe dhe prindërit e mi emigrantë që prej vitit 1991 në Greqi na u afruan për të ndihmuar meqenëse i kishin mundësitë. Duke qenë se banorët e pallatit ku jetonim në Pogradec na propozuan të ndërtonim bashkërisht një shtesë anësore për pallatin (secili të zgjeronte apartamentin e vet ekzistues), ideja për të blerë apartament nuk u realizua kurrë.*

Me kalimin e viteve prindërit e mi nuk kanë dashur t’ua kthenim këtë shumë parash, por e kanë parë si një garanci për kthimin në një moment kur atyre do t’ju nevojitej. Me të ardhurat që kemi, kjo shumë mund t’ju kthehet prindërve në çdo moment që ata do të kenë nevojë, meqenëse tani janë në moshën e tretë. Vlen të theksoj se e gjithë familja ime e përbërë nga prindërit, dy motra dhe një vëlla jetojnë në shtetin grek që prej vitit 1991”.

Në lidhje me burimin e krijimit, subjekti ka shpjeguar se prindërit e saj kanë qenë në emigracion në shtetin grek që nga viti 1991. Punësimi i prindërve të saj ka qenë burimi i të ardhurave të tyre. Për të provuar të ardhurat e ligjshme të prindërve⁴⁹, subjekti ka depozituar një sërë dokumentesh.

Komisioni shqyrtoi dokumentacionin dhe analizoi të ardhurat e ligjshme të provuara me dokumentacion, duke i paraqitur në tabelën vijuese.

Përshkrimi	Periudha 2000 – 2004
Të ardhura totale për periudhën 2000 – 2004	9.893 euro

⁴⁸Në përgjigjet e pyetësorit, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021.

⁴⁹Dokumentacioni i depozituar: vërtetim i Departamentit të Sigurisë P, për bimin e prindërve në P, Greqi, prej shumë vitesh (origjinali përkthyer dhe noterizuar); vërtetim nga Ujësijellës-Kanalizime për pagesa të kryera nga K.K; vërtetim deklarim punëdhënësi, datë 30.12.2002; dokument i bursa “O”, datë 31.1.2001, për llogari aksionesh në emër të V.K; dokument i bursa “O”, datë 31.1.2002, për llogari aksionesh në emër të V. K; dokument i bursa “O”, datë 31.7.2003, për llogari aksionesh në emër të V.K; dokument i bursa “O”, datë 31.10.2003, për llogari aksionesh në emër të shtetasës V.K; dokument, datë 24.10.2000, për depozitim shumë në “Alpha Bank” për llogari në emër të V.K; dokument, datë 29.2.2000, për depozitim shume në “Alpha Bank” për llogari në emër të V.K; deklaratë përgjegjësie në E** E, e datës 29.2.2000; dokument, datë 4.10.2000, për depozitim aksionesh në A *** në “Alpha Bank” për llogari aksionesh në emër të V.K; dokument ekstrakt i llogarisë individuale të sigurimit, tremujori i parë i vitit 2003 për V.K; dokument ekstrakt i llogarisë individuale të sigurimit, tremujori i parë i vitit 2003 për V.K; dokument ekstrakt i llogarisë individuale të sigurimit, tremujori i dytë i vitit 2003 për K.K; dokument ekstrakt i llogarisë të siguruarit për K.K; vendim gjyqësor në lidhje me zbatimin e Kodit të Procedurave Tatimore të Greqisë, botuar në fletoren zyrtare në datën 20.10.2017, ku theksohet se *zgjatja e kufizimeve për rastet tatimore është jokushtetuese. Afati për kontrollin tatimor nuk mund të zgjasë përtej një afati parashkrimi pesëvjeçar*. Subjekti shprehet se: *“E depozitohet këtë vendim, pasi është shumë e vështirë të sigurohen dokumente të plota nga bankat dhe institucionet e tjera në Greqi përtej këtij afati dhe periudha që shtrihet kërkesa e prindërve të mi është rreth 17 vjet më parë”*; vërtetim për të ardhurat e tatueshme të personit fizik në bazë të deklarimit fillestar për K. Z. K, lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Greqisë, sipas të dhënave të sistemit (dokumente origjinale me vulë apostile të përkthyer dhe noterizuara); vërtetim vendbanimi të përhershëm nr. *** prot., datë 25.10.2021, lëshuar nga Departamenti i Policisë Bashkiake P, Greqi, për V.Th. K, dokumente origjinale me vulë apostile të përkthyer dhe noterizuara; vërtetim leje qëndrimi të përhershëm nr. GR ***, lëshuar nga Departamenti i Policisë Bashkiake P, Greqi, për K.Z.K (dokument i përkthyer dhe noterizuar).

Shpenzime jetike sipas EUROSTAT-it ⁵⁰	35.210 euro
Shumë e dhënë subjektit	14.925 euro
Rezultati	- 40.242 euro

Nga analizimi i dokumenteve që subjekti vuri në dispozicion në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 20.000 USD, duket se prindërit e saj nuk kanë pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme në periudhën 2000 – 2004, për t'i dhënë këtë shumë dhe përballimin e jetesës së tyre, pasi kjo është periudha që provohet punësimi i prindërve të saj.

11.2 Në lidhje me shumën 20.000 USD, dhënë nga prindërit e subjektit, konstatohet se:

- Mungon dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për hapjen e depozitës në shumën 41.417 USD. Për pasojë, kjo shumë nuk është konsideruar në analizën financiare të subjektit në vitin 2004.

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën.

11.3 Qëndrimi i subjektit

Subjekti, në prapësime, ka kërkuar që Komisioni të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në analizë të ardhurat e prindërve dhënë subjektit në shumën 20.000 USD, të realizuara nga punësimi i tyre në Greqi. Subjekti ka shpjeguar se prindërit e saj kanë jetuar në shtetin grek që në vitin 1991, vit në të cilin janë të punësuar dhe për një periudhë 13-vjeçare kanë pasur mundësi të krijonin të ardhura të mjaftueshme për t'i dhënë subjektit shumën e pretenduar, pasi puna ishte burimi i tyre i të ardhurave.

Në vijim të shpjegimeve, subjekti ka pretenduar se prindërit e saj nuk gëzojnë cilësinë e personave të lidhur (huadhënës apo dhurues), për shumën prej 20.000 USD dhënë subjektit, referuar ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka shpjeguar se kjo shumë është dhënë për shkak të marrëdhënies së posaçme prind-fëmijë dhe mund t'ua kthejë prindërve të saj në çdo moment që atyre mund t'i nevojitet. Kjo shumë, dhënë vajzës së tyre, nuk përfaqëson as dhurim dhe as hua, por i janë dhënë në një moment që subjekti po zgjeronte familjen dhe planifikonte të gjente një zgjidhje për strehim.

Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar që për të ardhurat e dhëna nga prindërit, për shkak se ka kaluar një kohë shumë e gjatë që kur janë krijuar, duhet të vendoset në kushtet e pamundësisë objektive, referuar pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84.2018, pasi referuar edhe në legjislacionin tatimor të shtetit grek, dokumentacioni tatimor ruhet deri në 5 vjet.

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk ka depozituar dokumentacion shtesë.

11.4 Vlerësimi i Komisionit

Komisioni, në lidhje me pretendimin e subjektit se është në pamundësi objektive për të provuar burimet e ligjshme, sikurse u argumentua edhe më sipër, vlerëson se subjekti duhet të provonte që ndodhej në kushtet e parashikuara në nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016, sipas kësaj dispozite, dokumenti që provon të ardhurat e ligjshme të prindërve është zhdukur, ka humbur, nuk mund

⁵⁰<https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

të bëhet përsëri apo nuk merret në rrugë tjetër. Nga aktet e depozituara nga subjekti, rezulton e provuar që prindërit e saj kanë qenë të punësuar për periudhën 2002 – 2004. Pra, subjekti provoi punësimin e prindërve, nuk u provon që kanë përfituar të ardhura në atë masë sa t'i jepnin shumën prej 20.000 USD dhe të përballonin shpenzimet e jetesës së tyre.

Komisioni vlerëson se mosparaqitja e dokumenteve nga subjekti nuk është për shkaqe të arsyeshme, pasi ka provuar punësimin e tyre, subjekti është në pamundësi të provojë të ardhurat në masën e deklaruar prej saj.

Komisioni, sikurse është shprehur më lart, për aq sa nuk është depozituar dokumentacion provues për pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e prindërve të realizuara në Greqi për vitet 1991 – 2004, rezulton se nuk përmbushen standardet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për rrjedhojë, edhe sikur prindërit e saj të kishin krijuar të ardhura, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme. Në përfundim, Komisioni vlerëson se të ardhurat e krijuara nga prindërit gjatë punës së tyre në Greqi, të cilat përmbushin standardet e ligjshmërisë, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, nuk mjaftojnë për të mbuluar dhe shumën e dhënë subjektit. Në këtë rast, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, sipas parashikimit ligjor gërma “b”, pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me pretendimin e subjektit se shumat e dhëna nga prindërit nuk janë as dhurim dhe as hua, Komisioni arsyeton se prindërit e subjektit janë në kategorinë e personave të tjerë të lidhur, referuar pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se: *“Persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë apo juridikë që duket se kanë apo kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit [...] që rrjedh nga një interes pasuror apo çdo marrëdhënie tjetër biznesi”*.

Nisur nga fakti që shuma e dhënë nga prindërit që nga viti 2004 e në vijim është disponuar nga subjekti dhe ka shërbyer për krijimin e depozitës në shumën 41.417 USD në vitin 2004 dhe nga kjo depozitë bankare janë përfituar të ardhura, pavarësisht masës së përfituar, mjafton për të provuar marrëdhënien e interesit, duke klasifikuar prindërit si “persona të tjerë të lidhur”.

Nisur nga fakti që shuma prej 20.000 USD u përdor si burim për ndërtimin e shtëpisë 3-katëshe, subjekti ka detyrimin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për këtë shumë, në përputhje me pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Nga analizimi i të ardhurave të ligjshme të prindërve kanë rezultuar të jenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shumat e dhëna subjektit të rivlerësimit.

12. Analiza financiare pas prapësimeve

Komisioni, sa më sipër u argumentua, rikreu analizën e përgjithshme financiare të subjektit.

Në analizën financiare të vitit 2016, subjekti ka ngitur pretendim për një përlllogaritje të gabuara në analizë, ku nga verifikimi u evidentua se ky pretendim i subjektit qëndron, pasi rezultoi një lapsus në shumën prej 1.365.909 lekë, shumë e korrigjuar në analizën finale financiare.

Analiza e përgjithshme financiare, pas prapësimeve, për periudhën 2003 – 2016, ka rezultuar me një balancë negative në shumën rreth 5.208.072 lekë, sipas tabelës vijuese.

Vitet	Pasuri	Diferencë likuiditeti	Detyrime	Pasuri Neto	Të ardhura	Shpenzime	Rezultati financiar
2003	-	-	-	-	1 662 193	508 520	1 153 673
2004	3 898 764	3 898 764	-	3 898 764	1 719 911	547 120	- 2 725 974
2005	393 974	393 974	-	393 974	1 319 419	848 909	76 536
2006	556 308	- 267 647	-	556 308	2 315 753	938 324	821 121
2007	1 375 688	1 375 688	-	1 375 688	2 758 057	958 156	424 213
2008	2 537 889	930 814	-	2 537 889	2 724 526	1 094 112	- 907 475
2009	1 232 601	167 935	-	1 232 601	2 769 937	1 334 122	203 214
2010	2 260 495	824 495	-	2 260 495	2 273 824	992 547	- 979 217
2011	85 979	- 6 523 553	-	85 979	2 251 498	1 859 616	305 902
2012	465 229	465 229	-	465 229	2 515 007	2 415 798	- 366 019
2013	855 930	539 093	-	855 930	2 930 743	1 233 705	841 108
2014	717 995	717 995	-	717 995	2 357 052	1 751 680	- 112 623
2015	828 173	828 173	-	828 173	4 153 732	2 016 473	1 309 086
2016	- 143 907	- 143 907	-	- 143 907	1 830 062	2 090 732	- 116 764
Total							- 5 208 072

Në vlerësim tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara në dosje, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues ka konstatuar se edhe pasi është rikryer analiza financiare, kryesisht duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit Elina Kombi, sërisht analiza përfundimtare nuk është në favor të subjektit pasi mungesa e burimeve të ligjshme është në masë të mjaftueshme për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Për këtë arsye, Komisioni gjykoi të përfundojë procesin e rivlerësimit të subjektit bazuar vetëm mbi kriterin e pasurisë, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke mos pranuar kërkesën e subjektit për riçeljen e hetimit dhe për 2 kriteret e tjera.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni për vlerësimin e kriterit të pasurisë, në shpjegimet e subjektit në seancat dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Elina Kombi:

- i. Nuk ka arritur të provojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurive, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.
- ii. Ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar krijimin e pasurisë dhe krijimin e likuiditeteve në bankë, në përputhje me germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Ka mungesë dokumentacioni provues për të ardhurat e fituara prej saj dhe bashkëshortit në SHBA, si dhe të prindërve në Greqi.
- iv. Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Elina Kombi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 3.2.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI

Kryesuese

Suela ZHEGU

Relatore

Firdes SHULI

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha